



Funded by  
the European Union

# Diskriminimi sistematik në hapësira dhe punësim



Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj



INTERNEWS KOSOVA

#### HEQJE E PËRGJEGJËSISË:

Ky raport është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit “Luftimi i diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës në baza gjinore” - zbatuar nga ATRC, Internews Kosova dhe D4D. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Internews Kosova dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Autorë:  
Flaka Fazlija  
Valon Fana

Metodologjia:  
Kreshnik Gashi

Redaktor:  
Kreshnik Gashi  
Naim Krasniqi

Lektura:  
Përparim Isufi

Dizajni:  
Granit Mavriqi  
Diar Vuçetaj

# Tabela e përmbajtjes

|  |           |
|--|-----------|
| <b>Përmbledhja Ekzekutive</b>  | <b>5</b>  |
| <b>Metodologjia</b>  | <b>7</b>  |
| <b>Sfidat e Universitetit të Prishtinës</b>                                      | <b>8</b>  |
| Kapacitetet e limituara të Fakultetit Juridik                                    | 10        |
| Kapacitetet e limituara të Fakultetit të Edukimit                                | 12        |
| Kapacitetet e limituara të Fakultetit të Filologjisë                             | 14        |
| <b>Sfidat e kryeqytetit</b>  | <b>15</b> |
| Kapacitetet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare - Prishtinë               | 17        |
| Kapacitetet në Qendrën e Mjekësisë Familjare - Bregu i Diellit                   | 18        |
| Kapacitetet e limituara në Shkollën e Mesme “Sami Frashëri” - Prishtinë          | 19        |
| Kapacitetet e limituara në Shkollën e Mesme “Xhevdet Doda” - Prishtinë           | 20        |
| Kapacitetet e limituara në Qendrën për Punë Sociale - Prishtinë                  | 21        |
| Kapacitetet e limituara të Pallatit të Rinisë - Prishtinë                        | 22        |
| <b>Sfidat në Komunën e Lipjanit</b>  | <b>23</b> |
| Qendra e Mjekësisë Familjare - Lipjan  | 24        |
| Kapacitetet e limituara të Qendrës për Punë Sociale - Lipjan                     | 25        |
| Kapacitetet e limituara të Shkollës Filllore “Ismajl Luma” - Lipjan              | 26        |
| Kapacitetet e limituara të Shkollës së Mesme - Gjimnazi “Ulpiana” - Lipjan       | 27        |
| <b>Sfidat e Komunës së Graçanicës</b>  | <b>28</b> |
| 10.1 Qendra e Mjekësisë Familjare  | 30        |
| 10.2 Shkolla e Mesme   | 30        |
| 10.3 Objekti i Komunës   | 30        |
| Kapacitetet e shkollës në Kishnicë   | 31        |
| <b>Sfidat në Komunën e Gjilanit</b>  | <b>32</b> |
| Kapacitetet e Drejtorisë së Administratës - Komuna e Gjilanit                    | 33        |
| Kapacitetet e Qendrës së Mjekësisë Familjare - Gjilan                            | 34        |
| Kapacitetet e limituara të Qendrës për Punë Sociale - Gjilan                     | 35        |
| Kapacitetet e limituara në Shkollën e Mesme “Zenel Hajdini” - Gjilan             | 36        |
| <b>Sfidat e Komunës së Vitisë</b>  | <b>37</b> |
| Kapacitetet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare - Viti                    | 39        |
| Kapacitetet e limituara në Shkollën e Mesme - Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës” - Viti | 40        |
| <b>Rekomandimet</b>  | <b>41</b> |
| <b>Udhëzues shpjegues për rregullat ligjore</b>                                  | <b>42</b> |



## Përmbledhje Ekzekutive

Kosova ka miratuar një varg ligjesh të cilat synojnë të garantojnë barazi dhe mosdiskriminim për grupet e marginalizuara dhe personat me aftësi të kufizuar.

Në parimet kushtetuese e ligjore, vendi garanton që këto kategori të mund të zhvillojnë jetën normalisht dhe të padiskriminuar. Por të dhënat tregojnë që obligimet ligjore nuk respektohen në shumë pika matëse dhe si rrjedhojë grupet e marginalizuara vazhdojnë të përballen me diskriminim. Ndalimi i diskriminimit, punësimi, mundësitë për avancim profesional, qasja e papenguar në hapësira të kujdesit shëndetësor dhe asistencë sociale janë disa nga obligimet themelore të cilat shteti ka marrë për obligim të zbatohet në raport me kategoritë e marginalizuara.

Por të dhënat tregojnë se obligimet ligjore në masë të madhe nuk zbatohen në terren.

Të dhënat e mbledhura nga Internews Kosova (I/KS) tregojnë se institucionet në nivel lokal nuk janë të njoftuara për obligimet ligjore dhe, si rrjedhojë, grupet e marginalizuara hasin në probleme infrastrukturore sa i përket qasjes fizike në institucione.

Një vlerësim i vitit 2020 shpërfaq se në nivel vendi janë të përmbushura vetëm 6,77 % e obligimeve infrastrukturore.<sup>1</sup>

Edhe pse shumë objekte publike janë të ndërtuara pas luftës apo të renovuara, ato e kalojnë pranimin teknik pa i përmbushur të gjitha kushtet ligjore për krijimin e qasjes së barabartë për personat me aftësi të kufizuar. As institucioni më i lartë ligjvënës në vend, Kuvendi i Kosovës, nuk i përmbush standardet për qasje të lirë për persona me aftësi të kufizuar.<sup>2</sup>

Hulumtimi i I/KS ka konstatuar probleme serioze në qasjen e personave me aftësi të kufizuar në institucionet që ofrojnë shërbime si qendrat për punë sociale dhe në shkollat publike të vendit. Një avancim për sa i përket qasjes është vërejtur tek institucionet shëndetësore. Shumica e institucioneve të vizituara gjatë hulumtimit nuk i kanë hapësirat përreth tyre të adaptuara për qasjen e personave me aftësi të kufizuar. Në këtë pjesë vërehet mungesë serioze e parkingjeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar.

Institucionet publike nuk kanë njohuri të mjaftueshme për obligimet që dalin nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe për diskriminim në përgjithësi, njëkohësisht nuk është arritur të zhvillohet një praktikë e mirëfilltë gjyqësore lidhur me të.<sup>3</sup>

Hulumtimi i I/KS shpërfaq probleme serioze me implementimin e një kornize të avancuar juridike për komunitetet pakicë, pasi që edhe përkundër kuotës së vendosur në disa institucione, në institucionet ku nuk është e vendosur kuota për punësim të pjesëtarëve të komuniteteve nuk ka pjesëtarë të punësuar.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas vazhdojnë të jenë të stigmatizuar, ndërsa shkalla e braktisjes së shkollimit të obligueshëm të fëmijëve nga këto komunitete mbetet e lartë.<sup>4</sup> Shqetësues është edhe numri i vogël i mësuesve nga këto komunitete dhe mospërfshirja e tyre në strukturat menaxhuese të arsimit.

Në shkolla ku mësojnë këto komunitete, komunat nuk kanë angazhuar mësimdhënës të cilët i përkasin këtyre komuniteteve.

Sfidues mbetet punësimi i personave me aftësi të kufizuar dhe mungesa e infrastrukturës adekuate që u siguron atyre qasje për në vendet e punës.

<sup>1</sup> Raport Hulumtues "Standardet Ndërkombëtare mbi Çështjet e Aftësisë së Kufizuar, ku Qëndron Kosova?", fq. 23, Mars 2020, Prishtinë

<sup>2</sup> Korrespondenca elektronike e Kallxo.com me HANDIKOS, 30 Tetor 2023

<sup>3</sup> Material i shkëputur nga procesverballi i Tryezës "Sfidat e sistemit gjyqësor në zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi", organizuar nga IAP, 15 Shtator 2021

<sup>4</sup> Arsimitimi i Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë, Qendra e Kosovës për Arsim, Nëntor 2021, Prishtinë

Hulumtimi i I/KS Zbulon se institucione të rëndësishme të vendit si Universiteti i Prishtinës nuk kanë asnjë person me aftësi të kufizuar të punësuar edhe pse punësojnë me qindra punëtorë të rregullt. Edhe në institucione ku personat me aftësi të kufizuar janë punësuar të dhënat tregojnë që numri i tyre është shumë i ulët. Hulumtimi i I/KS ka analizuar 26 njësi institucionale të cilat punësojnë mbi 3 mijë punëtorë, por të dhënat tregojnë se janë punësuar më pak se 10 persona me aftësi të kufizuar.

E përkundër mbrojtjes ligjore për komunitetin LGBTI+, pjesëtarët e këtij komuniteti vazhdojnë të mbesin pjesë e marginalizuar e shoqërisë.<sup>5</sup>

Punësimi i grave dhe përfshirja e tyre në pozicionet vendimmarrëse vazhdon të jetë problem.

Në drejtoritë komunale ku vjen në shprehje përgjegjësia politike përveç asaj juridike, ka dallime të hapura në numrin e drejtorive që drejtohen nga gratë dhe burrat.

Institucionet publike dhe private vazhdojnë të kenë mangësi të theksuara infrastrukturore sa i përket krijimit të qasjes së barabartë për personat me aftësi të kufizuar. Ligji është i qartë dhe i adreson nevojat e kësaj kategorie, por nuk gjen implementim, dhe veçanërisht jo të plotë, madje as nga vetë institucionet publike.

Të dhënat e grumbulluara nga I/KS tregojnë se në institucionet e vendit nuk ka një standard të unisuar dhe qasje të unisuar për t'i trajtuar këto probleme.

Të dhënat tregojnë që shkollat brenda një komune dallojnë në standardet e respektuara, institucionet administrative po ashtu dallojnë në standardet dhe kriteret të cilat i përdorin.

Si rrjedhojë, qeverisja dhe ndërtimi pa kriteret të standardizuara i institucioneve publike ka krijuar një laramani dhe mungesë standardi në të gjithë vendin.

---

<sup>5</sup> Raporti i Vitit 2022 për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, Departamenti Amerikan i Shtetit, fq. 26 dhe 27



## Metodologjia

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë mbledhur në mes muajve prill dhe nëntor 2023, bazuar në një metodologji të paracaktuar e cila ka mbledhur të dhëna nga pesë komuna dhe nga universiteti më i madh në Kosovë - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".

Sipas mostrës së përcaktuar, grumbullimi i të dhënave është bërë në ndërtesat e komunave, në qendrat e mjekësisë familjare dhe në shkollat më të mëdha publike në komunat përkatëse.

Të dhënat janë grumbulluar duke realizuar vizita direkte, duke plotësuar pyetësorë dhe zhvilluar intervista të thelluara me zyrtarët përgjegjës.

Për qëllime të këtij raporti janë realizuar 26 intervista me zyrtarë përgjegjës të institucioneve të cilat kanë shërbyer si mostra në përgatitjen e këtij raporti.

Janë realizuar 6 pyetësorë të standardizuar dhe janë kërkuar të dhëna statistikore nga institucionet e targetuara. Të dhënat e grumbulluara janë analizuar nga ekipi ligjor i I/KS për të dhënë tutje përfundimet e nxjerra në këtë raport. Me qëllim të qasjes sa më të lehtë në lexim, raporti është ndarë në kapituj sipas regjioneve.



## Sfidat e Universitetit të Prishtinës

|  |            |  |            |
|--|------------|--|------------|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Po         | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Jo         |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo         | Ankesa formale për diskriminim                                     | Jo         |
| Punësimi i komuniteteve                              | Jo         | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po         |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Jo         | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Pjesërisht |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Pjesërisht | Imponomi i deklaramit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo         |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Po         | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Jo         |

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” është institucioni më i madh publik në vend që ofron arsimin e lartë dhe përfshin 14 njësi akademike.<sup>6</sup>

Të dhënat e hulumtimit tregojnë se Universiteti i Prishtinës nuk garanton qasje të barabartë, të plotë dhe uniforme për studentët apo stafin me aftësi të kufizuar.

Në disa njësi akademike ka probleme substanciale me qasje në katet e dyta dhe të treta pasi që në shumicën e rasteve nuk ka ashensor dhe mungon sinjalistika.

Institucioni në fjalë nuk ka të dhëna për numrin e studentëve me aftësi të kufizuar që ndjekin studimet.

UP nuk ka të punësuar personel me aftësi të kufizuar dhe nuk ka persona nga radhët e komuniteteve joshumicë të punësuar.<sup>7</sup>

Ndërsa brenda rregullativës së brendshme të institucionit nuk ekzistojnë dispozita që parashohin lehtësime për punësim të punonjësve nga kjo kategori.<sup>8</sup>

Universiteti nuk imponon një procedurë formale standarde përmes së cilës u kërkon studentëve apo të punësuarve deklaramin e orientimit seksual, ndërkohë që nuk organizon ndonjë aktivitet për të promovuar të drejtat e komunitetit LGBTI+.<sup>9</sup>

Universiteti parasheh kuota inkurajuese me vende të veçanta për komunitetet që janë kategori kushtetuese në vendin tonë. Ata kanë mundësi që pa garuar me gjithë studentët e tjerë, vetëm me kalimin e pragut minimal, dhe me një garë shumë herë më të vogël të zhvilluar vetëm brenda aplikuesve të komunitetit përkatës, të përfitojnë nga vendet e rezervuara për ta. Kuota e pranimit për studentë nga komunitetet joshumicë është 12 për qind, përkatësisht deri në 200 studentë.<sup>10</sup>

<sup>6</sup> Plani Strategjik 2023-2025 i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, fq. 5, Korrik 2023, Prishtinë

<sup>7</sup> Pyetësi elektronik i Kallxo.com me Rektoratin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 23 Tetor 2023

<sup>8</sup> Pyetësi elektronik i Kallxo.com me Rektoratin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 23 Tetor 2023

<sup>9</sup> Pyetësi elektronik i Kallxo.com me Rektoratin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 23 Tetor 2023

<sup>10</sup> Konkursi i shpallur nga Senati i UPHP-së nr. 1/667, 13 Korrik 2023, Prishtinë



Statuti i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, i jep përparësi punësimit të grave në rastet kur kualifikimet dhe të arriturat profesionale të kandidatëve janë të barabarta. Momentalisht gratë përbëjnë shumicën e personelit administrativ me 57 për qind. Kërkesa e Ligjit për Barazi Gjinore është që përfaqësimi gjinor të jetë në shkallën 50-50.<sup>13</sup>

Në kuadër të Këshillit Drejtues nga 9 anëtarët, vetëm 2 janë gra<sup>14</sup> - ndërsa nga 5 prorektorët e Universitetit, 3 janë gra.<sup>15</sup> Obligimet ligjore për përfaqësim gjinor shtrihen edhe në rrafshin udhëheqës.<sup>16</sup>

Asnjë rast me bazë diskriminimi nuk është raportuar në këtë institucion.<sup>17</sup>

Universiteti nuk e ka ndarë me stafin e vet Konventën e Stambollit apo Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe nuk e mohon se ka mundësi që stafi të mos ketë njohuri për konventat respektive.<sup>18</sup>

Hulumtimi i I/KS është shtrirë edhe në njësi akademike të UP-së.

---

<sup>11</sup> Statuti i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Neni 8

<sup>12</sup> Pyetësi elektronik i Kallxo.com me Rektoratin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 23 Tetor 2023

<sup>13</sup> Ligji për Barazi Gjinore, neni 6, para. 8

<sup>14</sup> <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,10>, 13 Nëntor 2023

<sup>15</sup> <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,12>, 13 Nëntor 2023

<sup>16</sup> Ligji për Barazi Gjinore, neni 3, par. 1.15

<sup>17</sup> Pyetësi elektronik i Kallxo.com me Rektoratin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 23 Tetor 2023

<sup>18</sup> Pyetësi elektronik i Kallxo.com me Rektoratin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 23 Tetor 2023

## Kapacitetet e limituara të Fakultetit Juridik

|  |            |  |    |
|--|------------|--|----|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Po         | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Jo |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo         | Ankesa formale për diskriminim                                     | Jo |
| Punësimi i komuniteteve                              | Jo         | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Pjesërisht | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Po |
| Tualete të qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Jo         | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Po         | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Jo |

Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” është një nga njësitë më të mëdha me 4,068 studentë, përkatesisht 2,897 vajza që përbëjnë 72.21 për qind të numrit të përgjithshëm dhe 1,172 djem, që përbëjnë 28.81 për qind.

Stafi në tërësi ka 65 punëtorë, prej të cilëve 26 apo 38.23 për qind janë gra dhe 39 apo 57.35 për qind janë burra. Kjo bie ndesh me rregullativën ligjore e cila kërkon që përfaqësimi gjinor të jetë 50-50.<sup>20</sup>

Në pak vite Fakulteti Juridik ka pësuar mjaft ndryshime infrastrukturore, momentalisht ka pjerrina në hyrje të fakultetit, në korridor dhe në sallën e madhe të amfiteatrit. Ndërtesa gjithashtu posedon edhe dy ashensorë të cilët mundësojnë qasje për personave me aftësi të kufizuar në dekanat dhe administratë. Por Fakulteti akoma nuk e ka zgjidhur problemin e ashensorit apo qasjes në sallat e ligjërimit dhe ushtrimeve të cilat shkojnë deri në katin e katërt dhe ndodhen në anën tjetër të administratës/dekanatit e ku po ashtu mbahet edhe një numër i konsiderueshëm i provimeve e testeve. Në ndërtesë gjithashtu mungojnë tualetet për personat me aftësi të kufizuar.<sup>21</sup>

Këto mungesa infrastrukturore përbëjnë diskriminim dhe mospërmbushje të obligimeve që dalin nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.<sup>22</sup> Për më tepër ndeshja e dytë me ligjin e fakultetit që ligjëron pikërisht ligjin ndërlidhet me përcaktimin juridik se secili person me aftësi të kufizuar ka të drejtë në aftësim, riaftësim profesional,<sup>23</sup> sidomos në ndërlidhje me obligimin për dhënie të mundësive të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim.<sup>24</sup> Situata faktike me mungesë të qasjes adekuate i zhvendos këta persona me aftësi të kufizuar në situatë jo të barabartë pa pasur mundësinë e vijimit të jetës akademike si studentët e tjerë, përkatesisht stafi tjetër.

Anipse ka mbi 50 të punësuar, Fakultetit Juridik nuk ka asnjë të punësuar që është person me aftësi të kufizuar apo me prejardhje etnike nga komunitetet jo-shumicë.<sup>25</sup> Kjo situatë bie ndesh me obligimet ligjore që në çdo 50-të punësuar, i 51-ti të jetë nga radhët e personave me aftësi të kufizuar.<sup>26</sup>

<sup>19</sup> <https://juridiku.uni-pr.edu/page.aspx?id=1.8>, 18 Tetor 2023

<sup>20</sup> Ligji për Barazi Gjinore, Neni 6, para. 8

<sup>21</sup> Vizita e ekipit të Kallxo.com në Fakultetin Juridik - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, 19 Prill 2023

<sup>22</sup> Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 4, para. 1.8.

<sup>23</sup> Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar

<sup>24</sup> Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, neni 2, para. 1.3

<sup>25</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me dekanin e Fakultetit Juridik Avni Puka, 19.04.2023, Prishtinë

<sup>26</sup> Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar, neni 12

Në këtë njësi akademike studiojnë studentë të etnive të ndryshme<sup>27</sup> të cilët, siç ndodh në secilën njësi tjetër akademike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, janë të privilegjuar me kouata të veçanta për pranim. Kjo praktikë është e pranueshme konform kornizës së gjerë të mbrojtjes që Kosova ua ofron komuniteteve pakicë.

Ky fakultet nuk ka asnjë formë standarde përmes të cilës kërkohet identifikimi i orientimit seksual të të punësuarve apo studentëve të tij.<sup>28</sup>

Dekanati e konsideron të panevojshëm shpërndarjen te stafi të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Konventën e Stambollit si dhe Ligjin për Mbrojtje kundër Diskriminimit, marrë parasysh faktin se është pikërisht vendi ku ligjërohen këto akte.<sup>29</sup>

Aty nuk ka ngjarë të inicohet ndonjë procedurë disiplinore si pasojë e diskriminimit.<sup>30</sup>

---

<sup>27</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me Dekanin Avni Puka, 19.04.2023, Prishtinë

<sup>28</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me Dekanin Avni Puka, 19.04.2023, Prishtinë

<sup>29</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me Dekanin Avni Puka, 19.04.2023, Prishtinë

<sup>30</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me Dekanin Avni Puka, 19.04.2023, Prishtinë

## Kapacitetet e limituara të Fakultetit të Edukimit

|  |                      |  |    |
|--|----------------------|--|----|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Po                   | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Po |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo<br>(më shumë gra) | Ankesa formale për diskriminim                                     | Jo |
| Punësimi i komuniteteve                              | Jo                   | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Po                   | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Jo |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Po                   | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Po                   | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Jo |

I themeluar në vitin 2002,<sup>31</sup> Fakulteti i Edukimit është prej fakulteteve të reja në kuadër të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Të dhënat e siguruara tregojnë se nga 3,800 studentë sa ka kjo njësi në të gjitha nivelet, preferenca për të është hapur më e madhe në anën e studenteve vajza/gra. Këtu ndjekin studimet 3,000 studente apo 78.94 %, dhe vetëm 800 studentë djem/burra apo pak më shumë se 10 %.

Përfaqësimi gjinor në udhëheqjen e fakultetit është konform kërkesave ligjore për përfaqësim gjinor në organet udhëheqëse, pra 50 për qind burra dhe 50 për qind gra, me ç’rast dekanin dhe prodekanin për çështje mësimore - studimet bachelor janë burra, kurse prodekanja për çështje mësimore - studimet master si dhe prodekanja për studime të doktoraturës dhe sigurim të cilësisë janë gra.<sup>32</sup> Nga 68 të punësuar, 38 apo 55.88 % janë gra, kurse 44,11 % janë burra.

Në Fakultetin e Edukimit gjejmë një storie suksesi sa i përket kujdesit që i është kushtuar infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuar.

Hyrja ka pjerrinë, amfiteatri ku ligjërohet ka pjerrinë, dyert nuk kanë pragje, ka tualetet e përshtatura për persona me aftësi të kufizuar, e po ashtu ka edhe ashensorë në të gjitha katet.<sup>33</sup>

Edhe Qendra për Këshillim një zyrë e vogël ku studentët marrin shërbime dhe një hapësirë pune e cila mund të shfrytëzohet nga këta të fundit është vendosur në katin e parë.<sup>34</sup>

Në Fakultetin e Edukimit momentalisht nuk ka asnjë të punësuar me aftësi të kufizuar anipse ndër 58 të punësuar, konform dispozitave ligjore, do të duhej të ishte së paku një i tillë. Poashtu nuk ka asnjë të punësuar nga komunitetet jo-shumicë.<sup>35</sup>

Por aty studiojnë studentë nga të gjitha komunitetet tradicionalisht të pranishme në Kosovë, me përjashtim të komunitetit serb.<sup>36</sup>

Fakulteti nuk ka një formë standarde përmes së cilës stafit apo studentëve do t’u kërkohej identifikimi i orientimit seksual.<sup>37</sup>

<sup>31</sup> <https://edukimi.uni-pr.edu/>, 20 Tetor 2023

<sup>32</sup> <https://edukimi.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,12>, 20 Tetor 2023

<sup>33</sup> Vizita e ekipit të Kallxo.com në Fakultetin e Edukimit - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, 19 Prill 2023

<sup>34</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me Dekanin e Fakultetit të Edukimit Blerim Saqipi, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>35</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me Dekanin e Fakultetit të Edukimit Blerim Saqipi, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>36</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me Dekanin e Fakultetit të Edukimit Blerim Saqipi, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>37</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me Dekanin e Fakultetit të Edukimit Blerim Saqipi, 20 Prill 2023, Prishtinë

Kohë pas kohe stafi merr pjesë në trajnime të cilat janë kryesisht në fushën e edukimit, por edhe programe të veçanta për nxënësit viktime të dhunës, diskriminimit, ngacmimeve.<sup>38</sup>

As studentëve e as stafit nuk i është ndarë Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, Konventa e Stambollit apo Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, megjithatë janë ndarë rregulloret e Universitetit të cilat po ashtu e rregullojnë diskriminimin.<sup>39</sup>

---

<sup>38</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me Dekanin e Fakultetit të Edukimit Blerim Saqipi, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>39</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me Dekanin e Fakultetit të Edukimit Blerim Saqipi, 20 Prill 2023, Prishtinë

## Kapacitetet e limituara të Fakultetit Filologjik

|   |                   |  |           |
|---|-------------------|--|-----------|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                         | <b>Po</b>         | Asistent për persona me aftësi të kufizuara                        | <b>Jo</b> |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                        | <b>Po</b>         | Ankesa formale për diskriminim                                     | <b>Jo</b> |
| Punësimi i komuniteteve                               | <b>Jo</b>         | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | <b>Po</b> |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuara     | <b>Pjesërisht</b> | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | <b>Po</b> |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuara | <b>Jo</b>         | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | <b>Jo</b> |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                  | <b>Po</b>         | Punësimi i personave me aftësi të kufizuara                        | <b>Jo</b> |

Fakulteti i Filologjisë është themeluar që në vitin 1961.<sup>40</sup> Aty vazhdojnë të ndjekin studimet 3,000 studentët.<sup>41</sup>

Por për kaç shumë vite situata në Fakultetin e Filologjisë nuk ka ndryshuar pasi qasja për shumë persona me aftësi të kufizuara është e pamundur. Aty ka pjerrinë vetëm për qasje në katin e parë, por në katin e dytë ku po ashtu zhvillohet shumë prej jetës akademike të studentëve apo punonjësve si ligjërata, ushtrime, provime, etj... nuk ka një ashensor.

Fakulteti nuk ka tualetet e përshtatura për personat me aftësi të kufizuara dhe sinjalistikë për të verbrit.<sup>42</sup>

Fakulteti nuk ka asnjë person me aftësi të kufizuara të punësuar dhe nuk ka asnjë person nga radhët e komuniteteve jo-shumicë të punësuar.

Trajnime për stafin e këtij Universiteti ka kohë pas kohe falë bashkëpunimit me organizata të huaja por edhe bashkëpunimeve në mes të universiteteve.<sup>43</sup>

Kjo njësi akademike ka përmbushur rekuizitën ligjore për punësim 50-50 sa i përket përfaqësimit gjinor, dhe gjithashtu gratë drejtojnë punën e institucionit prej disa pozitave udhëheqëse, përfshirë pozitën e dekanes, prodekanes.<sup>44</sup>

Fakulteti nuk e ka ndarë Konventën e Stambollit, Konventën për Mbrojtjen për të Drejtat e Fëmijëve apo Ligjin për Mbrojtje kundër Diskriminimit me stafin apo studentët.<sup>45</sup>

<sup>40</sup> <https://filologjia.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,8>, 20 Tetor 2023

<sup>41</sup> Pyetësori i realizuar nga ekipi i Kallxo.com me Fakultetin Filologjik, 19 Prill 2023, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

<sup>42</sup> Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara neni 12

<sup>43</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me dekanen e Fakultetit Filologjik Lindita Rugova, 19 Prill 2023

<sup>44</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me dekanen e Fakultetit Filologjik Lindita Rugova, 19 Prill 2023

<sup>45</sup> Intervistë e ekipit të Kallxo.com me dekanen e Fakultetit Filologjik Lindita Rugova, 19 Prill 2023



## Sfidat e kryeqytetit

|  |            |  |                 |
|--|------------|--|-----------------|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Po         | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Po              |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo         | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Nuk ka të dhëna |
| Punësimi i komuniteteve                              | Po         | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po              |
| Qasja e barabartë për persona me aftësi të kufizuar  | Pjesërisht | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Po              |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Pjesërisht | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo              |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Po         | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Jo              |

Komuna e Prishtinës vazhdon të jetë larg arritjes së standardeve për qasjen pa kufizime të personave me aftësi të kufizuar dhe përfshirjes së tyre në jetën publike.

Në komunën e Prishtinës është i punësuar vetëm një person me aftësi të kufizuar, kurse në institucionet vartëse të kryeqytetit janë edhe 6 të tjerë.

Në mesin e fëmijëve që jetojnë në kryeqytet janë plotë 685 me aftësi të kufizuar, ndërsa hapësirat si shkollat ende vazhdojnë të jenë të papërshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuar.<sup>46</sup>

Kryeqyteti nuk organizon ndonjë aktivitet përmes të cilit do të promovonte të drejtat e komunitetit LGBTI+, megjithatë ndan subvencione për organizata që avokojnë për të drejtat e këtij komuniteti.

Si çdo institucion tjetër në Kosovë, komunës së Prishtinës i përcaktohen me Statut organe permanente për mbrojtjen e komuniteteve dhe përfaqësimin e tyre. Një nga organet komunale është Komiteti për Komunitete në të cilin përveç anëtarëve të Kuvendit, mund të përfshihen edhe përfaqësues të komuniteteve, të cilët nuk përfaqësohen në Kuvend, por janë banorë të komunës.<sup>47</sup>

Në institucionet edukativo-arsimore të Prishtinës vijojnë mësimet nxënës edhe nga komuniteti turk dhe boshnjak. Nga komuniteti turk janë gjithsej 274 nxënës në shkollat fillore dhe të mesme. Ndërsa nga komuniteti boshnjak janë gjithsej 14 nxënës në shkollat fillore dhe të mesme. Ata ndjekin mësimet në paralelet e ndara ku mësimet i marrin në gjuhën e tyre amtare<sup>48</sup> konform të drejtave të garantuara me legjislacionin vendor dhe konventat ndërkombëtare si komunitete pakicë. Kurse gjithsej 57 nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas vijojnë mësimin fillor në gjuhën shqipe.<sup>49</sup>

Nga të gjitha institucionet publike vartëse që futen nën ombrellën e Komunës së Prishtinës punojnë gjithsej 37 persona nga komunitetet jo-shumicë. Përkatësisht, 11 në institucionet komunale (8 serbë, 1 ashkali dhe 2 turq) dhe 26 persona të tjerë në shkollat e kryeqytetit. Asnjë prej këtyre të punësuarve nga komunitetet nuk është në pozitë udhëheqëse.<sup>50</sup>

<sup>46</sup>Pyetësori elektronik i Kallxo.com me Komunën e Prishtinës, 25 Tetor 2023

<sup>47</sup>Statuti i Komunës së Prishtinës, Neni 46, para. 46.1

<sup>48</sup>Pyetësori elektronik i Kallxo.com me Komunën e Prishtinës, 25 Tetor 2023

<sup>49</sup>Pyetësori elektronik i Kallxo.com me Komunën e Prishtinës, 25 Tetor 2023

<sup>50</sup>Pyetësori elektronik i Kallxo.com me Komunën e Prishtinës, 25 Tetor 2023

Komuna nuk ka një politikë e cila inkurajon punësimin e grave, megjithatë duke përjashtuar shëndetësinë dhe arsimin, brenda institucionit të komunës së Prishtinës gratë përbëjnë 45 për qind të të punësuarve. Kjo është në kundërshtim me kërkesat ligjore që përfaqësimi në institucionet publike të jetë në shkallën 50-50<sup>51</sup>. Në komunën e Prishtinës shërbejnë 17 drejtori, 10 prej të cilave apo 58.82 për qind janë të udhëhequra nga burrat dhe 7 apo 41.17 për qind janë të udhëhequra nga gratë.<sup>52</sup>

Komuna e ka shpërndarë Konventën e Stambollit të Mekanizmi Komunal kundër dhunës në familje dhe ka mbajtur edhe trajnim për procedurat standarde të veprimit, ka hartuar planin e veprimit të mekanizmit kundër dhunës në familje,<sup>53</sup> si dhe është në përfundim të Planit të Veprimit për Barazi Gjinore në harmoni me Konventën e Stambollit. Ndërsa sa i përket Konventës për Mbrojtjen e të Drejtat të Fëmijëve është krijuar ekipi komunal për të drejtat e fëmijëve sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe do fillohet me hartimin e planit të veprimit për të drejtat e fëmijëve. Ekipi përbëhet nga Kryetari Përparim Rama dhe të gjithë drejtorët e kryeqytetit si dhe anëtarët tjerë: zyrtari për koordinimin e të drejtave të njeriut/drejtat e fëmijëve, Avokati i Popullit, Policia e Kosovës dhe shoqëria civile.<sup>54</sup> Ky komunitet sigurohet që asnjë person i cili merr përsipër detyra publike ose mban post publik nuk guxon të bëjë diskriminim ndaj asnjë personi mbi kurrfarë baze; të gjithë qytetarët gëzojnë në mënyrë të barabartë, të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe mundësi të barabarta për punësim në shërbimet komunale/të qytetit; shërbimi civil komunal/personeli pasqyron në proporcion të drejtë numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve.<sup>55</sup>

Objekti i vjetër i Komunës së Prishtinës, nga vizita në terren, vërehet se ofron qasje për persona me aftësi të kufizuar. Por mungon akustika për të verbër.<sup>56</sup>

Ky objekt ka pjerrinë e cila u shërben të gjithë atyre personave me aftësi të kufizuar qasje me karrocë.

Gjithashtu, në objektin e vjetër të komunës ka një tualet të veçantë për persona me aftësi të kufizuar i cili është funksional. Ndërsa objekti ka edhe një ashensor i cili është i qasshëm nga kati përdhësë jashtë, e të cilin mund ta shfrytëzojnë personat me aftësi të kufizuar.

Siç kanë konfirmuar edhe zyrtarët komunalë, objekti i vjetër i komunës së Prishtinës e ka të ndarë edhe hapësirën për parking për persona me aftësi të kufizuar, por për shkak të punimeve, aktualisht nuk vërehen shenjëzimet.

Në objektin e komunës nga monitorimi vërehet se është niveluar një sportel për t`u ofruar qasje më të lehtë në shërbimet komunale përdoruesve të karrocës.

<sup>52</sup> <https://prishtinaonline.com/dreitorite/administrate>, 25 Tetor 2023

<sup>53</sup> [https://prishtinaonline.com/uploads/6.1\\_plani\\_lokal\\_i\\_veprimit\\_per\\_mbrojtje\\_nga\\_dhuna\\_ne\\_familje\\_l.pdf](https://prishtinaonline.com/uploads/6.1_plani_lokal_i_veprimit_per_mbrojtje_nga_dhuna_ne_familje_l.pdf), 25 Tetor 2023

<sup>54</sup> Pyetësi elektronik i Kallxo.com me Komunën e Prishtinës, 25 Tetor 2023

<sup>55</sup> Statuti i Komunës së Prishtinës, neni 47, pikat a, b, c

<sup>56</sup> Vizita e ekipit të Kallxo.com në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës, 16 Tetor 2023, Prishtinë



## Kapacitetet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare - Prishtinë

|   |                      |  |    |
|---|----------------------|--|----|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                         | Po                   | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Jo |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                        | Jo<br>(më shumë gra) | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo |
| Punësimi i komuniteteve                               | Jo                   | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar      | Po                   | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Jo |
| Tualetet të qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Po                   | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                  | Po                   | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Po |

Qendra e Mjekësisë Familjare në Prishtinë funksionon me 41 të punësuar, ku 38 punonjëse apo 92.68 për qind janë gra, kurse vetëm 3 punonjës apo 7.32 për qind janë burra.<sup>57</sup> Përfaqësimi i grave është prezent edhe në dy pozita udhëheqëse, si shefe e QMF-së dhe infermiere përgjegjëse.<sup>58</sup> Të gjithë të punësuarit në këtë qendër janë shqiptarë.<sup>59</sup>

Qendra e Mjekësisë Familjare në Breg të Diellit ofron parking të veçantë për persona me aftësi të kufizuar, ashensor, hyrje të lehtë me pjerrina dhe dyer me pragje tejte të ulëta, ka tualetet të akomoduara për këtë kategori, si dhe dimensionet e dyerve janë të përshtatshme për qarkullimin e karrocave.<sup>60</sup> Në këtë kuptim në këtë qendër janë përmbushur kërkesat për qasje të barabartë për personat me aftësi të kufizuar.

Qendra ka staf të trajnuar për të drejtat e njeriut dhe nuk ka pasur asnjë rast të ankimit për diskriminim. Madje kjo Qendër ka pasur edhe trajnime nga HANDIKOS për të drejtat e pacientëve/personave me aftësi të kufizuar.<sup>61</sup>

<sup>57</sup>Pyetësi i realizuar nga Kallxo.com me QMF në Breg të Diellit, 25 Prill 2023, Prishtinë

<sup>58</sup>Pyetësi i realizuar nga Kallxo.com me QMF në Breg të Diellit, 25 Prill 2023, Prishtinë

<sup>59</sup>Pyetësi i realizuar nga Kallxo.com me QMF në Breg të Diellit, 25 Prill 2023, Prishtinë

<sup>60</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në QMF-në në Breg të Diellit, 25 Prill 2023

<sup>61</sup>Pyetësi i realizuar nga Kallxo.com me QMF në Breg të Diellit, 25 Prill 2023, Prishtinë

## Kapacitetet në Qendrën e Mjekësisë Familjare - Bregu i Diellit

|  |                      |  |                 |
|--|----------------------|--|-----------------|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Po                   | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Po              |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo<br>(më shumë gra) | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo              |
| Punësimi i komuniteteve                              | Jo                   | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po              |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Po                   | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Nuk ka të dhëna |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Po                   | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo              |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Po                   | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Po              |

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, janë të punësuar 195 persona, prej të cilëve 141 apo 72.30 për qind janë gra, kurse 54 apo 27.7 për qind burra. Gratë drejtojnë punën e institucionit prej disa pozitave udhëheqëse, dhe atë si: kryeshefe, shefe të njësive, kryeinfermiere dhe infermiere përgjegjëse të qendrave.<sup>62</sup> Madje 80 për qind e pozitave udhëheqëse drejtohen pikërisht nga gratë.<sup>63</sup>

Të gjithë të punësuarit në këtë qendër janë shqiptar. Një i punësuar i përket kategorie së personave aftësi të kufizuar.<sup>64</sup>

Kjo qendër ua mundëson qasjen personave me aftësi të kufizuar pothuajse njëjtë si personave të tjerë. E vetmja mungesë është akustika për të verbër.<sup>65</sup> Brenda objektit ka pjerrina, ashensor, sinjalizime për të shurdhër si dhe tualetet e përshtatura dhe parkingje të veçanta për persona me aftësi të kufizuar.<sup>66</sup>

Institucioni ka staf të trajnuar mbi të drejtat e njeriut, megjithatë nuk e kanë ndarë me stafin Ligjin për Mbrojtje kundër Diskriminimit, Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve apo Konventa e Stambollit.<sup>67</sup>

Asnjë procedurë nuk e kërkon identifikimin e punonjësve apo pacientëve për çështje të orientimit seksual.<sup>68</sup>

Institucioni nuk ka pranuar ankesë për diskriminim në punësim apo dhënie të shërbimeve.<sup>69</sup>

<sup>62</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, 18 Prill 2023, Prishtinë

<sup>63</sup>Intervista e Kallxo.com me Arzije Krasniqi - QKMF Prishtinë, 18 Prill 2023

<sup>64</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, 18 Prill 2023, Prishtinë

<sup>65</sup>Intervista e Kallxo.com me Arzije Krasniqi - QKMF Prishtinë, 18 Prill 2023

<sup>66</sup>Vizita e Ekipit të Kallxo.com në QKMF Prishtinë, 18 Prill 2023, Prishtinë

<sup>67</sup>Intervista e Kallxo.com me Arzije Krasniqi - QKMF Prishtinë, 18 Prill 2023

<sup>68</sup>Intervista e Kallxo.com me Arzije Krasniqi - QKMF Prishtinë, 18 Prill 2023

<sup>69</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, 18 Prill 2023, Prishtinë

## Kapacitet e limtuara në Shkollën e Mesme “Sami Frashëri” - Prishtinë

|  |                   |  |    |
|--|-------------------|--|----|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Jo                | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Jo |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo (më shumë gra) | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo |
| Punësimi i komuniteteve                              | Po                | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Jo                | Shpërndarja me stafin/studentët e konventave ndërkombëtare         | Jo |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Po                | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Po                | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Jo |

Gjimnazi “Sami Frashëri” është një nga shkollat më të mëdha në kryeqytet.

Aty mësojnë 1,002 nxënës, prej të cilëve 649 apo 64.77 për qind janë vajza, kurse 353 apo 35.22 për qind janë djem. Trend i njëjtë i dominimit së paku numerik të vajzave/grave ku me 45 gra të punësuar apo 63.38 për qind në krahasim me 26 burra apo 36.32 për qind, gratë përbëjnë shumicën e të punësuarve. E megjithatë edhe drejtori edhe zëvendësi janë burra.<sup>70</sup>

Shkolla nuk plotëson standardet e qasjes për personat me aftësi të kufizuar për shkak se nuk ka qasje në katet e sipërme.

Gjithçka që Gjimnazi “Sami Frashëri” ofron për personat me aftësi të kufizuar është pjerrina në hyrje dhe tualetet e akomoduar,<sup>71</sup> ndërsa në këtë institucion arsimor nuk ka ashensor dhe sinjalistikë për të verbër e të shurdhër.<sup>72</sup>

Shkolla obligohet që në rast se ka nxënës me aftësi të kufizuar në një klasë ta bëjë zëvendësimin e klasës me një klasë në katin e parë ku ka qasje me karrocë.<sup>73</sup>

Ndërkohë shkolla asnjëherë nuk ka organizuar program special të trajnimit për stafin për këtë kategori, njëkohësisht nuk ka asnjë të punësuar me aftësi të kufizuar, anipse në të gjejnë punësim 71 punëtorë. Gjithashtu gjimnazi nuk ka pasur ndonjëherë program të aftësimin special profesional për personat me aftësi të kufizuar.<sup>74</sup>

Aty punojnë 3 arsimtarë të komunitetit turk, e mësojnë edhe 65 nxënës nga i njëjti komunitet.<sup>75</sup>

Shkolla del të mos ketë një formë standarde përmes të cilës e kërkon identifikimin e orientimit seksual të nxënësve apo mësimdhënësve.<sup>76</sup>

Shkolla ka staf të trajnuar mbi të drejtat e njeriut, por nuk e ka ndarë me stafin apo nxënësit Konventën e Stambollit, Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi apo Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Shkollës nuk i është raportuar asnjë rast për diskriminim, ndaj dhe nuk ka inicim të procedurave disiplinore mbi këtë bazë.

<sup>70</sup> Pyetësori i Kallxo.com me Gjimnazin “Sami Frashëri” Prishtinë, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>71</sup> Intervistë e Kallxo.com me zëvendës drejtorin e Gjimnazit, Daut Selimi, 20 Prill 2023

<sup>72</sup> Vizita e ekipit të Kallxo.com në Gjimnazin “Sami Frashëri”, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>73</sup> Intervistë e Kallxo.com me zëvendës drejtorin e Gjimnazit Daut Selimi, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>74</sup> Intervistë e Kallxo.com me zëvendës drejtorin e Gjimnazit Daut Selimi, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>75</sup> Pyetësori i Kallxo.com me Gjimnazin “Sami Frashëri”, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>76</sup> Intervistë e Kallxo.com me zëvendës drejtorin e Gjimnazit Daut Selimi, 20 Prill 2023

## Kapacitetet e limtuara në Shkollën e Mesme “Xhevdet Doda” - Prishtinë

|  |                           |  |    |
|--|---------------------------|--|----|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Jo                        | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Po |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo<br>(me shumë gra)      | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo |
| Punësimi i komuniteteve                              | Jo                        | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Pjesërisht                | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Po |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Po<br>(jashtë përdorimit) | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Po                        | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Jo |

Gjimnazi “Xhevdet Doda” me 1,169 nxënës është shkolla më e madhe e mesme në vend. Aty mësojnë 712 vajza ose 60.90 për qind, dhe 457 djem ose 39 për qind. Të gjithë nxënësit janë shqiptarë. Shkolla ka gjithsej 59 të punësuar, prej të cilëve 62.71 për qind apo 37 punëtorë janë gra, kurse 37.29 për qind apo 22 punëtorë janë burra.<sup>77</sup> Burrat janë të nënpërfaqësuar në këtë institucion publik. Gratë në këtë shkollë janë edhe pjesë e administratës, me ç’rast një grua e mban postin e sekretares dhe një tjetër postin e pedagoges.<sup>78</sup> Por edhe në këtë institucion ku gratë përbëjnë shumicën dërmuese të të punësuarave, përfaqësimi i tyre në pozita udhëheqëse lë për të dëshiruar. Aktualisht edhe drejtori dhe zëvendësdrejtori i gjimnazit janë burra.<sup>79</sup>

Në këtë shkollë nuk ka pasur asnjë raportim për diskriminim, dhe nuk është inicuar asnjë procedurë disiplinore lidhur me pretendime për shkelje të motivuara të barazisë. Shkolla ka staf të trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut, por e njëjta nuk e ka ndarë me stafin apo nxënësit Konventën e Stambollit, Ligjin për Mbrojtje kundër Diskriminimit apo Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Lajmi i mirë është se asnjëherë nuk është raportuar ndonjë rast për diskriminim, rrjedhimisht asnjëherë nuk është inicuar një procedurë disiplinore mbi këtë bazë.<sup>80</sup>

Asnjë procedurë nuk ua kërkon punonjësve apo nxënësve të gjimnazit identifikimin e orientimit të tyre seksual.<sup>81</sup>

Shkolla nuk ka sinjalistikë apo akustikë për personat e verbër dhe të shurdhër, as ashensor, por ka një pjerrinë në hyrje të shkollës dhe gjithashtu një tualet të akomoduar për nevojat e personave me aftësi të kufizuar. Meqenëse shkolla momentalisht nuk ka një nxënës apo punëtor që i përket kategorisë së aftësisë së kufizuar, ajo ka vendosur ta ridestinojë përdorimin e këtyre tualeteve. Këtu ndiqet shembulli i shumicës së shkollave dhe kurdo që ka një nxënës me aftësi të kufizuar ia mundësojnë që të gjithë shkollimin ta ndjekë në katin e parë.<sup>82</sup>

<sup>77</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Gjimnazin “Xhevdet Doda”, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>78</sup>Intervistë e Kallxo.com me drejtorin e Gjimnazit “Xhevdeto Doda” Azem Jaha, 20 Prill 2023

<sup>79</sup>Vizita e Kallxo.com në Gjimnazin “Xhevdet Doda”, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>80</sup>Intervistë e Kallxo.com me drejtorin e Gjimnazit “Xhevdet Doda” Prishtinë Azem Jaha, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>81</sup>Intervistë e Kallxo.com me drejtorin e Gjimnazit “Xhevdet Doda” Prishtinë Azem Jaha, 20 Prill 2023, Prishtinë

<sup>82</sup>Pyetësori i Kallxo me Gjimnazin “Xhevdet Doda” Prishtinë, 20 Prill 2023, Prishtinë

## Kapacitetet e limituara në Qendrën për Punë Sociale - Prishtinë

|  |                             |  |           |
|--|-----------------------------|--|-----------|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | <b>Po</b>                   | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | <b>Po</b> |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | <b>Jo</b><br>(me shumë gra) | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | <b>Jo</b> |
| Punësimi i komuniteteve                              | <b>Jo</b>                   | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | <b>Po</b> |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | <b>Jo</b>                   | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | <b>Po</b> |
| Tualete të qasshme për persona me aftësi të kufizuar | <b>Jo</b>                   | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | <b>Jo</b> |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | <b>Jo</b>                   | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | <b>Jo</b> |

Qendra për Punë Sociale në Prishtinë ka 49 të punësuar prej të cilëve 36 apo 73.46 për qind janë gra, kurse 11 apo 26.54 për qind janë burra.<sup>83</sup>

Gratë në këtë institucion zotërojnë edhe një numër pozitash udhëheqëse, përfshirë: udhëheqëse të njësisë, udhëheqëse të shërbimit social (tri gra), udhëheqëse të skemës së ndihmës sociale (tri gra) dhe udhëheqëse të departamentit të administratës. Në anën tjetër burrat drejtojnë institucionin prej vetëm dy pozitave udhëheqëse.<sup>84</sup>

Dega kryesore e Qendrës për Punë Sociale e cila do të duhej pikërisht t'i bënte qytetarët të ndjeheshin më afër përkujdesjes shtetërore ka probleme serioze me infrastrukturën për personat me aftësi të kufizuar. Aty nuk ka as pjerrina, as ashensor, as sinjalistikë e akustikë për të verbër e për të shurdhër.<sup>85</sup>

Aty nuk ka asnjë të punësuar nga komunitetet pakicë të vendit, dhe asnjë të punësuar me aftësi të kufizuar. Ky institucion ka staf të trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut. Për më tepër ata e kanë ndarë me stafin Ligjin për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, Konventën e Stambollit si dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Me stafin e QPS-së në Prishtinë janë mbajtur mbi 10 trajnime për Konventën e Stambollit.<sup>87</sup>

Në këtë institucion nuk është iniciuar asnjë procedurë mbi bazën ankesave për diskriminim, njëkohësisht QPS-ja respektive nuk ka hartuar programe të veçanta për viktime të dhunës, diskriminimit apo ngacmimeve.<sup>88</sup>

<sup>83</sup>Pyetësi i Kallxo.com me QPS - Prishtinë, 26 Prill 2023

<sup>84</sup>Pyetësi i Kallxo.com me QPS - Prishtinë, 26 Prill 2023

<sup>85</sup>Vizita e Kallxo.com në objektin e Qendrës për Punë Sociale, 26 Prill 2023, Prishtinë

<sup>86</sup>Vizita e Kallxo.com në objektin e Qendrës për Punë Sociale, 26 Prill 2023, Prishtinë

<sup>87</sup>Intervistë me Vebi Mujku, drejtor i QPS Prishtinë, 26 Prill 2023, Prishtinë

<sup>88</sup>Intervistë me Vebi Mujku, drejtor i QPS Prishtinë, 26 Prill 2023, Prishtinë

## Kapacitetet e limituara të Pallatit të Rinisë në Prishtinë

|  |            |  |    |
|--|------------|--|----|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Po         | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Jo |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo         | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo |
| Punësimi i komuniteteve                              | Jo         | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Jo |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Pjesërisht | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Jo |
| Tualete të qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Jo         | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Po         | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Jo |

Pallati i Rinisë është objekti më i madh sportiv që ofron salla dhe hapësira për aktivitete kulturore e sportive.<sup>89</sup> Aty gjejnë punësim 99 punonjës, prej të cilëve 74 apo 74.74 % janë burra, dhe 26 apo 25.26 % janë gra. Por përkundër kësaj gratë drejtojnë punën e institucionit prej disa pozitive udhëheqëse, duke përfshirë: kryeshefen dhe katër udhëheqëse të sektorëve.<sup>90</sup>

Përkundër funksionimit prej një kohe mjaftë të gjatë, vetëm vitin e kaluar Pallati i Rinisë ka ndërtuar një pjerrinë për qasje në Pallat për persona me aftësi të kufizuar, e pjerrina që e mundëson qasjen në Sallën e Kuqe është akoma një strukturë e përkohshme. Megjithatë institucioni publik, i cili me iniciativën e ish-kryetarit të komunës Shpend Ahmeti hyri nën ombrellën e Komunës së Prishtinës, synon ta heqë këtë bazë të përkohshme dhe ta ndërtojë një tjetër e cila i përmbush standardet. Një tjetër element evident infrastrukturor është mungesa e pragjeve e cila e lehtëson qarkullimin për këtë kategori,<sup>91</sup> por edhe mungesa e ashensorëve e cila e vështirëson të njëjtën. Tjetër element zhgënjës është edhe mungesa e tualeteve të akomoduar.<sup>92</sup> Aty nuk ka punonjës të deklaruar që i përkasin kësaj kategorie, dhe as ndonjë asistent i dedikuar veçanërisht për këtë kategori. Megjithatë udhëheqësia thotë se janë në planifikim të buxhetit dhe duke shkruar projekte të cilat besojnë se do të ju mundësojnë ofrimin e punësimit të kësaj kategorie në Pallatin e Rinisë. Stafi nuk ka ndjekur ndonjë program të aftësimin special profesional për personat me aftësi të kufizuar.<sup>93</sup>

Struktura etnike e të punësuarve është krejt homogjene, të gjithë janë shqiptarë.<sup>94</sup>

Institucioni nuk ka asnjë procedurë standarde përmes të cilës e kërkon identifikimin e punonjësve apo personave të tjerë që krijojnë marrëdhënie pune me të si pjesë e komunitetit LGBTI+.<sup>95</sup>

Punonjësve të stafit nuk u është shpërndarë ndonjëherë Ligji për Mbrojtje kundër Diskriminimit, Konventa e Stambollit apo Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.<sup>96</sup>

Në këtë institucion nuk është inicuar asnjëherë një procedurë me bazë diskriminimin.<sup>97</sup>

<sup>89</sup><https://manifesta14.org/sq/venue/pallati-i-rinise-dhe-sporteve/>, 23 10 2023

<sup>90</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Pallatin e Rinisë, 25 Prill 2023, Prishtinë

<sup>91</sup>Intervista e Kallxo.com me kryeshen e NPL "Palati i Rinisë" Mrika Gashi, 25 Prill 2023, Prishtinë

<sup>92</sup>Vizita e Kallxo.com në Pallatin e Rinisë, 25 Prill 2023, Prishtinë

<sup>93</sup>Intervista e Kallxo.com me kryeshen e NPL "Palati i Rinisë" Mrika Gashi, 25 Prill 2023, Prishtinë

<sup>94</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Pallatin e Rinisë, 25 Prill 2023, Prishtinë

<sup>95</sup>Intervista e Kallxo.com me kryeshen e NPL "Palati i Rinisë" Mrika Gashi, 25 Prill 2023, Prishtinë

<sup>96</sup>Intervista e Kallxo.com me kryeshen e NPL "Palati i Rinisë" Mrika Gashi, 25 Prill 2023, Prishtinë

<sup>97</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Pallatin e Rinisë, 25 Prill 2023, Prishtinë



## Sfidat në Komunën e Lipjanit

|   |    |  |                 |
|---|----|--|-----------------|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                         | Po | Asistent për persona me aftësi të kufizuara                        | Jo              |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                        | Jo | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo              |
| Punësimi i komuniteteve                               | Po | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po              |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuara     | Po | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Nuk ka të dhëna |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuara | Po | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Nuk ka të dhëna |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                  | Po | Punësimi i personave me aftësi të kufizuara                        | Po              |

Në objektin komunal janë të punësuar 190 punonjës, prej të cilëve 124 burra apo 65 për qind dhe 66 janë gra apo 37.73 për qind.<sup>98</sup> Kjo situatë paraqet përfaqësim të pabarabartë gjinor përkitazi me dispozitat e Ligjit mbi Barazinë Gjinore, e cila kërkon që përfaqësimi të jetë 50-50.<sup>99</sup> Megjithatë gratë e drejtojnë institucionin kryesor lokal prej disa pozitave udhëheqëse, përfshirë: shefen e sektorit, drejtoreshën e komunës, zëdhënësen e komunës, etj...<sup>100</sup>

Komuna është e vendosur në një objekt të ri i cili është përfunduar më 28 nëntor të vitit 2022. Aty ka pjerrina, ashensor, tualet, printer brail dhe parkingje të veçanta për persona me aftësi të kufizuara. Tre qytetarë të komunës Lipjanit me aftësi të kufizuara janë punonjës të komunës.<sup>101</sup> Kjo nënkupton se objekti komunal i përmbush kriteret ligjore për mos diskriminim si dhe inkuadrimin e kësaj kategorie të shoqërisë.

Struktura etnike e stafit është e mjaft heterogjene, aty punojnë katër punonjës të komunitetit ashkali dhe serb.

Komuna ka staf të trajnuar për rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut. Aty madje funksionon një këshill i veçantë i formuar për persona me aftësi të kufizuara i përbërë nga 13 persona.<sup>102</sup>

<sup>98</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Komunën e Lipjanit, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>99</sup>Ligji për Barazi Gjinore, neni 3 para. 1.15, neni 6, para. 8

<sup>100</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Komunën e Lipjanit, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>101</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në objektin e komunës së Lipjanit, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>102</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Komunën e Lipjanit, 27 Prill 2023, Lipjan

## Qendra e Mjekësisë Familjare - Lipjan

|  |                 |  |    |
|--|-----------------|--|----|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Po              | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Jo |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo              | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo |
| Punësimi i komuniteteve                              | Po              | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Po              | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Po |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Jo              | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Nuk ka të dhëna | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Po |

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Mehdi Zejnullahu” në Lipjan është vend pune për 88 persona. Aty janë të punësuar 49 burra apo 55.68 për qind dhe 34 gra apo 38.63 për qind.<sup>103</sup> Kjo strukturë gjinore e të punësuarve është në kundërshtim me kërkesat për përfaqësim gjinor 50 - 50 në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore.

Në QKMF ka përfshirje të komuniteteve të ndryshme pasi aty përveç shumicës shqiptare, punojnë edhe një punëtor nga radhët e komunitetit ashkali, një kroat dhe dy punëtorë serbë. QKMF-ja ka të inkuadruar në procesin e punës edhe katër punëtorë me aftësi të kufizuar, përfshirë një infermier, një mjek dhe dy punëtorë teknikë.<sup>104</sup>

Objekti ofron qasje optimale për personat me aftësi të kufizuar, duke respektuar kështu kërkesat ligjore, përfshirë pjerrina, ashensor, tualet në katin e parë ndonëse të pa-akomoduar, parkingje të veçanta për këtë kategori, si dhe dhomat dhe sallat nuk kanë pengesa.<sup>105</sup>

QKMF-ja ka staf të trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut, por thotë të mos ketë pranuar asnjëherë ankesë për diskriminim, ndaj dhe nuk ka inicuar kurrë një procedurë për të trajtuar diçka të tillë. Ky institucion shëndetësor nuk ka pasur ndonjë program të aftësimit special profesional për personat me aftësi të kufizuar.<sup>106</sup>

<sup>103</sup>Pyetësi i Kallxo.com me QKMF “Dr. Mehdi Zejnullahu” - Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>104</sup>Pyetësi i Kallxo.com me QKMF “Dr. Mehdi Zejnullahu” - Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>105</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në QKMF “Dr. Mehdi Zejnullahu” - Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>106</sup>Pyetësi i Kallxo.com me QKMF “Dr. Mehdi Zejnullahu” - Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan



## Kapacitetet e limituara të Qendrës për Punë Sociale - Lipjan

|  |                             |  |    |
|--|-----------------------------|--|----|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Po                          | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Jo |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo<br>(në shtet të burrave) | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo |
| Punësimi i komuniteteve                              | Po                          | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Po                          | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Po |
| Tualete të qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Pjesërisht                  | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Po |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Po                          | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Po |

Qendra për Punë Sociale në Lipjan është vend pune për 13 persona, prej të cilëve 9 apo 69.23 për qind janë gra dhe 4 apo 30.76 për qind janë burra. E prej pozitave udhëheqëse një grua është drejtoreshë e QPS-së.<sup>108</sup>

QPS-ja ka të punësuar edhe një punëtor nga komuniteti serb si zyrtar i asistencës dhe ndihmave sociale ndërsa një e punësuar në administratë i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuar.<sup>109</sup>

Qasja për personat me aftësi të kufizuar lë për të dëshiruar. Kati i parë ofron qasje, pjerrinë, sallat janë pa pragje, ndërkohë që mungojnë ashensori, sinjalistika dhe akustika për të verbër e të shurdhër si dhe tualetet e akomoduar.<sup>110</sup> Por qendra është në fillimin e një projekti i cili ofron qasje për persona me aftësi të kufizuar. Ky projekt financohet nga projekti “EU for all”, së bashku me MAPL-në.<sup>111</sup>

QPS u ka ofruar punë praktike edhe praktikantëve nga komunitetet serb, rom dhe ashkali.<sup>112</sup>

Të gjithë pjesëtarët e komunitetit LGBTI+ nëse kanë nevojë trajtohen me dinjitetin më të madh të mundshëm, si çdo qytetar tjetër, ndonëse rastet e tilla që paraqiten ë QPS janë të pakta. Në formularë gjithmonë kërkohet deklarimi për orientimin seksual, vetëm se ekziston mundësia e deklarimit alternativ.<sup>113</sup>

Institucioni nuk ka asistent për persona me aftësi të kufizuar, por QPS-ja ka staf të trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut. Udhëheqësia është treguar e kujdesshme që t'i ndajë me stafin Konventën e Stambollit, Konventën për Mbrojtjen për të Drejtat e Njeriut dhe Ligjin kundër Diskriminimit. Qendra ka bashkëpunuar me OJQ “Polis” për të ofruar shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuar, ndërsa momentalisht e kanë një plan me UNICEF për shërbime të integruara.<sup>114</sup>

<sup>107</sup>Pyetësori i Kallxo.com me QPS - Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>108</sup>Pyetësori i Kallxo.com me QPS - Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>109</sup>Pyetësori i Kallxo.com me QPS - Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>110</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në QPJ - Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>111</sup>Intervistë e Kallxo.com me Makfirete Shamolli, drejtoreshë në QPS - Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>112</sup>Intervistë e Kallxo.com me Makfirete Shamolli, drejtoreshë në QPS - Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>113</sup>Intervistë e Kallxo.com me Makfirete Shamolli, drejtoreshë në QPS - Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>114</sup>Pyetësori i Kallxo.com me QPS - Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

## Kapacitetet e limituara të Shkollës Filllore “Ismajl Luma” - Lipjan

|   |                           |  |    |
|---|---------------------------|--|----|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                         | Jo                        | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Po |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                        | Jo<br>(në dëm të burrave) | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo |
| Punësimi i komuniteteve                               | Jo                        | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar      | Pjesërisht                | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Po |
| Tualetet të qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Po                        | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                  | Po                        | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Jo |

Shkolla fillore “Ismajl Luma” në Lipjan ka 724 nxënës, prej të cilëve 388 janë djem apo 53.59 për qind dhe 336 janë vajza apo 46.40 për qind. Kurse të punësuar janë 56 punëtorë, prej të cilëve 41 gra apo 73.21 për qind dhe 15 burra apo 26.78 për qind. Përveç si mësimdhënëse e mirëmbajtëse, gra janë edhe psikologjia e logopedja e shkollës, kurse udhëheqja e shkollës i është besuar një burri.<sup>115</sup>

Rreth 100 nxënës të komunitetit ashkali ndjekin mësimet në klasa të përbashkëta me nxënësit tjerë në këtë shkollë, por të punësuar nga radhët e komuniteteve nuk ka. Të punësuar nuk ka as nga personat me aftësi të kufizuar.<sup>116</sup>

Sa i përket qasjes për personat me aftësi të kufizuar shkolla ofron qasje të lehtë në katin e parë me pjerrinë, tualet të veçantë në katin e parë por në katet e sipërme nuk ka tualete për personat me aftësi të kufizuar. Shkolla nuk ka ashensor, nuk ka sinjalistikë dhe akustikë për të shurdhër apo të verbër, e as parkingje të veçanta për këtë kategori. Në anën tjetër, shkolla ka edhe psikologjen, logopedin dhe asistentët që janë në përkrahje të fëmijëve. Gjatë procesit mësimor janë të angazhuar tre asistentë të ndryshëm, një nga komuna, një nga shoqata e fëmijëve me aftësi të kufizuar, dhe një asistent vullnetar. Po ashtu ka edhe logopedin. Në përgjithësi shkolla ka një staf të trajnuar sa i përket punës me fëmijë.<sup>117</sup>

Në hyrje të shkollës evidentohet Rregullorja për të Drejtat e Nxënësit.<sup>118</sup> Shkolla ka staf të trajnuar mbi rregullativën juridike për të drejtat e njeriut. Drejtorja e shkollës i ka ndarë me stafin Konventën e Stambollit, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Madje qoftë përmes kopjeve fizike apo atyre elektronike në e-mail e grupe të përbashkëta në vazhdimësi i kushtohet vëmendje përditësimeve ligjore.<sup>119</sup>

Shkolla nuk ka pranuar asnjë raportim apo ankesë për diskriminim, rrjedhimisht nuk ka inicuar asnjë procedurë për të trajtuar diçka të tillë. Por në rast se ndodhë ndonjë ngacmim, diskriminim, rasti trajtohet nga psikologjia dhe stafi tjetër mbështetës, arsimtarët e kujdestarët.<sup>120</sup>

Shkolla nuk ka asnjë procedurë standarde përmes të cilës kërkon identifikimin e orientimit seksual të nxënësve apo stafit.<sup>121</sup>

<sup>115</sup>Pyetësi i Kallxo.com me Shfmu “Ismajl Luma” Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>116</sup>Pyetësi i Kallxo.com me Shfmu “Ismajl Luma” Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>117</sup>Intervista e Kallxo.com me drejtorin e Shfmu “Ismajl Luma” Driton Sadiku, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>118</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në Shfmu Shfmu “Ismajl Luma” Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>119</sup>Intervista e Kallxo.com me drejtorin e Shfmu “Ismajl Luma” Driton Sadiku, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>120</sup>Pyetësi i Kallxo.com me Shfmu “Ismajl Luma” Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>121</sup>Intervista e Kallxo.com me drejtorin e Shfmu “Ismajl Luma” Driton Sadiku, 27 Prill 2023, Lipjan

## Kapacitetet e limituara të Shkollës së Mesme - Gjimnazi “Ulpiana” - Lipjan

|  |    |  |    |
|--|----|--|----|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Po | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Jo |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo |
| Punësimi i komuniteteve                              | Jo | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Jo | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Jo |
| Tualete të qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Jo | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Po | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Jo |

Gjimnazi “Ulpiana” në Lipjan ka 1,363 gjimnazistë, prej të cilëve 808 vajza apo 59.28 për qind dhe 555 djem apo 40.71 për qind. Në këtë shkollë janë të punësuar 83 persona prej të cilëve 49 burra apo 59.03 për qind dhe 35 gra apo 40.96 për qind. Përveç si mësime të mësimdhënësve e mirëmbajtëse, gra janë edhe administratorja e psikologjia e shkollës, kurse pozitat e drejtorit dhe zëvendës drejtorit janë burra.<sup>122</sup>

Në shkollë ndjekin mësimet edhe nxënës nga komunitetet rom, ashkali, egjiptas, të cilët janë të inkuadruar në klasa të përbashkëta me shumicën tjetër. Kurse të punësuar të etnive/komuniteteve tjera pos asaj shqiptare nuk ka.<sup>123</sup>

Sa i përket qasjes për personat me aftësi të kufizuar ekzistojnë pjerrina apo nyje sanitare në katin e parë, kurse në katin e dytë dhe të tretë nuk ka ashensor apo qasje tjetër alternative. Klasat nuk kanë pragje, por tualetet kanë edhe pragje dhe nuk janë të akomoduar për nevojat e personave me aftësi të kufizuar. Sinjalistika dhe akustika për personat e verbër dhe të shurdhër po ashtu mungon. E në parking nuk është shënuar asnjë vend i rezervuar për këtë kategori.<sup>124</sup>

Shkolla ka staf të trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut. Stafit madje ka ndjekur edhe trajnime për të drejtat e fëmijëve. Ky institucion arsimor posedon edhe rregulloren e brendshme të shkollës e cila i parasheh të gjitha sjelljet edhe të punëtorit edhe të nxënësit brenda saj. Ajo rregullore u jepet në vazhdimësi mësime të mësimdhënësve, të cilët e lexojnë para nxënësve. Konventa e Stambollit apo Ligji për Mbrojtjen kundër Diskriminimit nuk janë shpërndarë me stafin.<sup>125</sup>

Shkolla nuk ka pranuar asnjë raportim për diskriminim dhe rrjedhimisht nuk ka zhvilluar asnjë procedurë për të trajtuar diçka të tillë. Megjithatë shkolla ka një zyrë të veçantë brenda shkollës me një ekip të trajnuar mes mësime të mësimdhënësve dhe nxënësve mbi diskriminimin dhe shkeljen e të drejtave të njeriut. Ata merren me raste të tilla.

<sup>122</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Gjimnazin “Ulpiana” Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>123</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Gjimnazin “Ulpiana” Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>124</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në Gjimnazin “Ulpiana” Lipjan, 27 Prill 2023, Lipjan

<sup>125</sup>Intervista e Kallxo.com me Drejtorin e Gjimnazit “Ulpiana” Lipjan, Semir Gashi, 27 Prill 2023, Lipjan



## Sfidat e Komunës së Graçanicës

|  |                 |  |                 |
|--|-----------------|--|-----------------|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Nuk ka të dhëna | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Nuk ka të dhëna |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo              | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Nuk ka të dhëna |
| Punësimi i komuniteteve                              | Po              | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Nuk ka të dhëna |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Pjesërisht      | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Nuk ka të dhëna |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Jo              | Imponomi i deklaramit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo              |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Po              | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Jo              |

Komuna e Graçanicës u ofron personave me aftësi të kufizuar pjerrina në shumicën e institucioneve publike, përfshirë shkolla, institucione shëndetësore dhe objekte të tjera komunale. Gjithashtu komuna ua shënjeron hapësirën e veçantë të parkingut për persona me aftësi të kufizuar në rrugë publike.<sup>126</sup> Por anipse në shumë institucione publike mungojnë ashensorët dhe ndonjëherë edhe pjerrinat, e sinjalistika për të verbër dhe të shurdhër çdokund,<sup>127</sup> komuna është përpjekur që në ndërtimet e reja publike të kenë gjithçka të nevojshme për qasjen e kësaj kategorie. Ata momentalisht po veprojnë vetëm me buxhetin komunal pa ndonjë donator në këtë segment.

Në shërbimet publike të Graçanicës ka vetëm një të punësuar me aftësi të kufizuar në Departamentin e Arsimit dhe Kulturës në kuadër të stafit mbështetës. Organet lokale nuk janë përkujdesur të respektohen kërkesat ligjore që në çdo 50 punëtorë, i 51-ti të jetë me aftësi të kufizuar.

Megjithatë organet lokale kanë treguar kujdes të mos krijohen baza për diskriminim dhe nuk kanë imponuar kurrfarë procedure për identifikimin e orientimit seksual as për marrësit e shërbimeve në komunë, as punonjësit, e as nxënësit.

Në këtë komunë, shumica e nxënësve janë serbë, 85.35 për qind, komunitetet tjera përbëjnë 11,85 për qind, e nxënësit shqiptarë janë 2.80 për qind.<sup>128</sup> Pushteti lokal nuk i bën të qasshme të dhënat se sa shkolla apo paralele të ndara ku nuk mësohet në gjuhën serbe funksionojnë brenda komunës, apo nëse kanë ndonjë akt të brendshëm juridik i cili rregullon themelimin e institucioneve të tilla arsimore.<sup>129</sup>

Në ekzekutivin komunal janë të punësuar 4 shqiptarë dhe 2 goranë, kurse edhe dy punëtorë të komuniteteve të tjera janë pjesë e Departamentit të Arsimit dhe Kulturës si pjesë e të punësuarve nga komunitetet jo-shumicë. Sa i përket pjesës administrative njëri është zyrtar administrativ, tjetri staf mbështetës, kurse në ekzekutivin lokal njëri shërben si nënkryetar i komunës për komunitete, njëri shërben si udhëheqës i zyrës për komunitete dhe kthim, njëri është përkthyes, njëri nëpunës për çështje parlamentare, si dhe dy inspektorë të ndërtimit. Gjithsej dy persona janë në pozita menaxheriale.<sup>130</sup>

<sup>126</sup>Përgjigja me e-mail e Komunës së Graçanicës në pyetësin e Kallxo.com, 16 Tetor 2023

<sup>127</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në Graçanicë, 5 Tetor 2023, Lipjan


<sup>128</sup>Përgjigja me e-mail e Komunës së Graçanicës në pyetësin e Kallxo.com, 16 Tetor 2023

<sup>129</sup>Korrespondenca me e-mail e ekipit të Kallxo.com me Komunën e Graçanicës, 10 Tetor 2023

<sup>130</sup>Përgjigja me e-mail e Komunës së Graçanicës në pyetësin e Kallxo.com, 16 Tetor 2023

Komuna nuk ka një politikë të veçantë e cila e inkurajon shkollimin e vajzave apo punësimin e tyre. Përfaqësimi gjinor është si në vijim:

## Ekzekutivi komunal:



## Departamenti i Kulturës dhe Arsimit:



Kjo nënkupton se komuna e Graçanicës nuk i respekton kërkesat ligjore për përfaqësim gjinor 50-50 në institucione publike.

Nga vizita në Komunën e Graçanicës shihet se objekti i kësaj komune u mundëson qasje personave me aftësi të kufizuar, përmes pjerrinave.

Në parkingun para objektit të komunës gjithashtu ka vendparking të veçantë të shenjëzuar për persona me aftësi të kufizuar. E megjithatë akustika për të verbër dhe sinjalistika për të shurdhër mungon.<sup>131</sup> Kjo nënkupton se komuna në fjalë i plotëson vetëm pjesërisht kërkesat ligjore karshi personave me aftësi të kufizuar. Komuna e Graçanicës po ashtu nuk i ka bërë të qasshme të dhënat për gratë në pozita udhëheqëse, apo nëse Konventa e Stambollit, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ose Ligji për Mbrojtje kundër Diskriminimit është ndarë me stafin apo nxënësit.<sup>132</sup>

Nga vizita në Komunën e Graçanicës, shihet si objekti i kësaj komune që u mundëson personave me aftësi të kufizuar qasje për të gjithë ata që janë me karrocë, pasi ka pjerrina.

Në parkingun para objektit të komunës, gjithashtu ka parking të veçantë të shenjëzuar për persona me aftësi të kufizuar.

<sup>131</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në Komunën e Graçanicës, 5 Tetor 2023, Graçanicë  
<sup>132</sup>Korropodencia elektronike e Kallxo.com me Komunën e Graçanicës, 16 Tetor 2023

## Kapacitetet e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - Graçanicë

Të dhënat e siguruara nga monitorimi tregojnë se objekti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Graçanicë, në hyrje të tij, është i qasshëm për persona me aftësi të kufizuar, pasi nuk ka shkallë dhe pragje, pra hyrja është në formë pjerrine që e lehtëson hyrjen e personave me aftësi të kufizuar. Gjithashtu shihet se objekti nuk e ka një parking të veçantë për persona me aftësi të kufizuar, ndërsa tualetet nuk janë të akomoduara për nevojat e kësaj kategorie, mungon edhe ashensori për katin e dytë, që do t`u mundësonte qasje në këtë pjesë personave me aftësi të kufizuar.<sup>133</sup> Këto të dhëna shpërfaqin faktin se ky institucion i përmbush vetëm minimalisht kërkesat ligjore për këtë kategori.

Ky institucion nuk ka pranuar të bashkëpunojë për të ofruar të dhëna të tjera për nevojat e këtij raporti.

---

<sup>133</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në Komunën e Graçanicës, 5 Tetor 2023, Graçanicë

## Kapacitetet e Shkollës “Ditët e Minatorit” - Kishnicë

|  |                                    |  |           |
|--|------------------------------------|--|-----------|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | <b>Jo</b>                          | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | <b>Po</b> |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | <b>Jo</b><br>(në shtet të burrave) | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | <b>Jo</b> |
| Punësimi i komuniteteve                              | <b>Jo</b>                          | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | <b>Jo</b> |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | <b>Pjesërisht</b>                  | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | <b>Jo</b> |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuar | <b>Po</b>                          | Imponomi i deklaramit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | <b>Jo</b> |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | <b>Po</b>                          | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | <b>Jo</b> |

Shkolla “Ditët e Minatorit” në Kishnicë është një ndër shkollat e pakta me shumicë shqiptare në komunën e Graçanicës. Aty punojnë 24 mësime, nga të cilët 13 apo 54.16 për qind janë gra dhe 11 apo 45.83 për qind janë burra. Anipse me një epërsi të lehtë, gratë e përbëjnë shumicën e stafit por ato nuk janë të pozicionuara në të vetmin rol udhëheqës të shkollës - drejtorit.<sup>134</sup>

Shkolla ka gjithsej 154 nxënës, 77 vajza dhe 79 djem. Me përjashtim të tre nxënësve të komunitetit rom të gjithë të tjerët janë shqiptarë.<sup>135</sup>

Shkolla është një objekt i ri në të cilin janë shfrytëzuar përparësitë e planifikimit në kohë dhe i është kushtuar njëfarë kujdesi qasjes për personat me aftësi të kufizuar. Shkolla ka pjerrinë në hyrje, ka pragje të rrafshta, një tualet të akomoduar për këtë kategori, sinjalizime për të shurdhër. Por asaj i mungon ashensori për katin e dytë si dhe akustika për të shurdhër. Një asistent është i angazhuar i cili shërben një nxënësi përdorues i karrocës, por nuk kanë pasur program të aftësimi special profesional për personat me aftësi të kufizuar dhe nuk ka asnjë punonjës i cili është me aftësi të kufizuar.<sup>136</sup>

Shkolla jo vetëm që nuk ka një procedurë standarde përmes të cilës e kërkon identifikimin e orientimit seksual, po udhëheqësia e saj e konsideron këtë gjë si të drejtë të secilit dhe, sipas tyre, secili duhet të ndihet ashtu siç dëshiron.<sup>137</sup>

Stafi i shkollës është i njoftuar me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, por shkolla thotë të mos i ketë shpërndarë me ta Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Konventën e Stambollit.<sup>138</sup>

<sup>134</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Sh.f.m.u. “Ditët e Minatorit”, 10 Prill 2023, Kishnicë, Graçanicë

<sup>135</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Sh.f.m.u. “Ditët e Minatorit”, 10 Prill 2023, Kishnicë, Graçanicë

<sup>136</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në Shfmu “Ditët e Minatorit”, 10 Prill 2023, Kishnicë,

<sup>137</sup>Intervistë e Kallxo.com me Vezir Bytyqi, drejtor i shkollës “Ditët e Minatorit”, 10 Prill 2023, Kishnicë, Prishtinë

<sup>138</sup>Intervistë e Kallxo.com me Vezir Bytyqi, drejtor i shkollës “Ditët e Minatorit”, 10 Prill 2023, Kishnicë, Prishtinë



## Sfidat në Komunën e Gjilanit

Komuna e Gjilanit është një tjetër komunë ku ka mungesa të theksuara në infrastrukturën për persona me aftësi të kufizuar. Kjo komunë ka të dhëna empirike për këtë aspekt vetëm sa i përket shkollave, me ç'rast 90% e shkollave kanë pjerrina, e vetëm 6 prej tyre kanë tualete të akomoduar.<sup>139</sup> Kjo gjendje paraqet një nivel tejet të ulët të përmbushjes së nevojave infrastrukturore në raport me kërkesat e ligjit, në bazë të së cilave do të duhej të kishte edhe ashensor, akustikë për të verbër e sinjalistikë për të shurdhër. Për më tepër momentalisht ky organ udhëheqës i gjilanasve nuk ka asnjë projekt apo bashkëpunim aktiv për momentin i cili do të shënonte nisjen e jetësimit të një vizioni potencial sa i përket këtij aspekti. Krejt kjo duke pasur mbi 200 nxënës me aftësi të kufizuar pa përmendur moshat e tjera. E ndonëse këtyre nxënësve nuk u ofrohet infrastruktura e duhur, e as nuk përkrahen financiarisht nga Drejtoria e Arsimit, ata ndihmohen në shkollim duke u siguruar, asistentë, interpretë, edukatorë mbështetës dhe mësimdhënës mbështetës.<sup>140</sup>

Komuna e Gjilanit që në total ka 12 drejtori ka një disproporcion të theksuar gjinor, vetëm 4 gra apo 33.33 për qind janë drejtore në krahasim me 8 burra apo 66.66 për qind të drejtorëve në total.<sup>141</sup> Obligimi për përfaqësim të barabartë gjinor është i obligueshëm ligjërisht edhe për nivelet vendimmarrëse.<sup>142</sup>

<sup>139</sup>Korrespondenca elektronike e Kallxo.com me Komunën e Gjilanit, 1 Nëntor 2023

<sup>140</sup>Korrespondenca elektronike e Kallxo.com me Komunën e Gjilanit, 1 Nëntor 2023

<sup>141</sup><https://kk.rks-gov.net/gjilan/nees/drejtores-komunale-te-gjilanit-prezantimine-punen-3-mujore-janar-mars-2023/>, 27 Tetor 2023

<sup>142</sup>Ligji për Barazi Gjinore, neni 3 para, 1.15



## Kapacitetet e Drejtorisë së Administratës - Komuna e Gjilanit

|  |                 |  |            |
|--|-----------------|--|------------|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Po              | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Po         |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo              | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Po         |
| Punësimi i komuniteteve                              | Po              | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po         |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Pjesërisht      | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Pjesërisht |
| Tualete të qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Jo              | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo         |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Nuk ka të dhëna | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Po         |

Administrata e përhershme e Drejtorisë së Administratës në komunën e Gjilanit përbëhet prej 42 personave. Prej tyre 28 apo 66.66 për qind janë burra, dhe 14 apo 33.33 për qind janë gra.<sup>143</sup> Kjo situatë paraqet përfaqësim jo të barabartë gjinor bazuar në kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore, i cili kërkon që çdo institucion publik të këtë përfaqësim gjinor 50-50.<sup>144</sup> Vetë Drejtoria e Administratës drejtohet nga një grua.<sup>145</sup> Përfaqësimi i barabartë gjinor është i obligueshëm ligjërish edhe për nivelet vendimmarrëse.<sup>146</sup>

Në drejtori përveç shumicës shqiptare janë të punësuar edhe një rom dhe një serb. I pari shërben te Qendra për Shërbime me Qytetarë ku bën pranimin e të gjitha kërkesave që u adresohen zyrtarëve të Qendrës së Komunës, kurse zyrtarja tjetër punon në gjendjen civile, i pajis qytetarët me dokumente, bën regjistrimin e lindjeve dhe vdekjeve.<sup>147</sup>

Investimet e fundit në objektin ku është e vendosur administrata janë bërë pa dy vitesh. Këto investime kanë sjellë disa përmirësime drejt përmbushjes së obligimeve që dalin përkitazi me krijimin e qasjes së barabartë për personat me aftësi të kufizuar. Janë ndërtuar pjerrina në hyrje të objektit por edhe brenda tij. Por janë lënë anash krijimi i sinjalistikës dhe akustikës adekuate për persona të shurdhër dhe të verbër, nuk janë shenjëzuar parkingjet e veçanta për këtë kategori, si dhe nuk është bërë akomodimi i tualetit që ndodhet në katin e parë. Pozitiv është fakti që ka asistent brenda institucionit në rast nevojë për persona me nevoja të tilla. Zyrtarët komunalë kanë mbajtur trajnime për personat me aftësi të kufizuar, ata që kanë problem me të folurit, gjuhën e shenjave.<sup>148</sup>

Në administratën komunale në Gjilan ka staf të trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut. Në këtë administratë e cila vepron në objekt të ndarë nga stafit politik i kryetarit është paraqitur vetëm njëherë para tri vitesh gojarisht një ankesë për diskriminim, dhe atë mbi bazën e diskriminimit të komunitetit rom.<sup>149</sup>

Administratës i është ndarë Ligji për Mbrojtje kundër Diskriminimit dhe pasojat prej tij. Zyrtarët po ashtu janë mirë të informuar me të drejtat e fëmijëve, por jo edhe me Konventën e Stambollit.<sup>150</sup>

<sup>143</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Drejtorinë e Administratës - Komuna e Gjilanit, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>144</sup>Ligji për Barazi Gjinore, neni 3 para, 1.15, neni 6, para. 8

<sup>145</sup><https://kk.rks-gov.net/gjilan/administrate/>, 27 Tetor 2023

<sup>146</sup>Ligji për Barazi Gjinore, neni 3 para, 1.15

<sup>147</sup>Intervista e Kallxo.com me Ardian Foniqi, zyrtar - Drejtoria e Administrës, Komuna e Gjilanit, 3 Maj 2023

<sup>148</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në Drejtorinë e Administratës, Komuna e Gjilanit, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>149</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Drejtorinë e Administratës - Komuna e Gjilanit, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>150</sup>Intervista e Kallxo.com me Ardian Foniqi, zyrtar - Drejtoria e Administrës, Komuna e Gjilanit, 3 Maj 2023

## Kapacitetet e Qendrës së Mjekësisë Familjare - Gjilan

|  |                             |  |    |
|--|-----------------------------|--|----|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                          | Po                          | Asistent për persona me aftësi të kufizuara                        | Jo |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                         | Jo<br>(në shtet të burrave) | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo |
| Punësimi i komuniteteve                                | Po                          | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Jo |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuara      | Pjesërisht                  | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Jo |
| Tualetet të qasshme për persona me aftësi të kufizuara | Po                          | Imponimi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                   | Nuk ka të dhëna             | Punësimi i personave me aftësi të kufizuara                        | Jo |

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Nagip Rexhepi” ka 240 të punësuar. Prej tyre, 183 apo 76.25 për qind janë gra dhe 77 apo 32.08 për qind prej punonjësve janë burra.<sup>151</sup> Gratë e udhëheqin punën e institucionit në disa prej pozitave udhëheqëse, përfshirë drejtoren, shefen e shërbimeve, ushtruesen e detyrës së kryeinfermieres dhe infermieret përgjegjëse. Kompozicioni etnik i stafit është më i larmishëm, aty përveç shumicës shqiptare punojnë edhe turq e romë.<sup>152</sup>

Kjo QKMF është e vendosur në një objekt të ri dhe ka filluar punën aty vetëm prej korrikut të vitit 2022, avantazhi në kohë është shprehur në një kujdes më të madh në përshtatjen e objektit përkitazi me nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Objekti ka parking të shenjëzuar, ashensorë, 10 tualetet të veçanta të akomoduar, shenjëzimet nëpër korridore dhe nuk ka pragje. Megjithatë ka nevojë të punohet për sigurimin e akustikës për të verbër.<sup>153</sup> Përkundër numrit të madh të punonjësve në këtë institucion shëndetësor nuk punon asnjë person me aftësi të kufizuara. Stafit tjetër ekzistues nuk ka ndjekur kurrfarë programi të veçantë të aftësimin profesional për punën me persona me aftësi të kufizuara.<sup>154</sup>

Në këtë institucion nuk ka asnjë procedurë standarde që kërkon identifikimin e orientimit seksual të punonjësve apo atyre që marrin shërbime aty. Por kjo jo sepse detyrimisht është zgjedhje e institucionit, QKMF-ja shërbehet me formularë dhe procedura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik.<sup>155</sup>

QKMF-ja nuk ka staf të trajnuar mbi rregullativën ligjore. Madje institucioni nuk ka as kod të mirësjelljes apo rregullore etike. Por në këtë drejtim, ata nuk kanë pasur asnjë raportim apo ankesë mbi bazën e diskriminimit.

<sup>151</sup>Pyetësori i Kallxo.com me QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>152</sup>Pyetësori i Kallxo.com me QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>153</sup>Vizita e Kallxo.com në objektin e QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>154</sup>Pyetësori i Kallxo.com me QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>155</sup>Intervista e Kallxo.com me Arbenita Hajdari - drejtoreshë, QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”, 3 Maj 2023, Gjilan

## Kapacitetet e limituara të Qendrës për Punë Sociale - Gjilan

|   |                             |  |                 |
|---|-----------------------------|--|-----------------|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                         | Po                          | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Jo              |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                        | Jo<br>(në shtet të burrave) | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo              |
| Punësimi i komuniteteve                               | Po                          | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po              |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar      | Jo                          | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Po              |
| Tualetet të qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Jo                          | Imponimi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Nuk ka të dhëna |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                  | Jo                          | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Po              |

Qendra për Punë Sociale në Gjilan ka 11 punëtorë, prej të cilëve 8 apo 72.72 për qind janë gra dhe 3 apo 27.27 për qind janë burra.<sup>156</sup>

Në këtë qendër përveç shqiptarëve punon edhe një serbe si zyrtare për asistencë.<sup>157</sup> Në qendër ka të punësuar një punëtor me aftësi të kufizuar me kontratë të rregullt dhe dy punëtorë tjerë nga kjo kategori me kontrata mbi shërbimet.

Objekti i QPS-së është renovuar para 10 vitesh, që atëherë nuk ka pasur iniciativa për të vijuar me përshtatjen e mëtutjeshme të tij për personat me aftësi të kufizuar. Ky institucion i plotëson shumë pak obligimet ligjore për qasje të barabartë për ata që kanë aftësi të kufizuar. Vetëm një pjerrinë në katin e parë është menduar për këtë kategori, ndërkohë që kati i dytë është pa asensor apo ndonjë qasje tjetër alternative. Tualetet nuk janë të akomoduar, akustika dhe sinjalistika e nevojshme për të shurdhër e të verbër po ashtu është inekzistente.<sup>158</sup>

Stafi ka ndjekur program të aftësimit special profesional për personat me aftësi të kufizuar të cilët janë realizuar në bashkëpunim me HANDIKOS-in dhe kanë pasur në qendër pikërisht punën me njerëz me nevoja të tilla.<sup>159</sup>

QPS-ja ka staf të trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut. E ankesat për diskriminim i kanë pranuar vetëm në formë verbale, por askush nuk është drejtuar formalisht me ankesë për diçka të tillë.<sup>160</sup>

Ky institucion është i informuar dhe i ka ndarë me stafin Ligjin për Mbrojtje kundër Diskriminimit, Konventën e Stambollit dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.<sup>161</sup>

<sup>156</sup>Pyetësori i QPS - Gjilan me Kallxo.com, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>157</sup>Intervista me Drejtorin e QPS - Gjilan, Mursel Zymeri, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>158</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në QPS-në në Gjilan, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>159</sup>Pyetësori i QPS - Gjilan me Kallxo.com, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>160</sup>Pyetësori i QPS - Gjilan me Kallxo.com, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>161</sup>Intervista me Drejtorin e QPS - Gjilan, Mursel Zymeri, 3 Maj 2023, Gjilan

## Kapacitetet e limituara në Shkollën e Mesme “Zenel Hajdini” - Gjilan

|  |                 |  |    |
|--|-----------------|--|----|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Jo              | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Po |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Nuk ka të dhëna | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo |
| Punësimi i komuniteteve                              | Jo              | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Po |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Jo              | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Jo |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Po              | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Jo |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Jo              | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Jo |

Gjimnazi “Zenel Hajdini” në Gjilan ka të punësuar 68 punonjës ndërsa aty ndjekin mësimet 760 nxënës. Gratë nuk janë pjesë e drejtorisë së shkollës, struktura etnike e shkollës është krejt homogjene: punonjësit e nxënësit janë të gjithë shqiptarë.<sup>162</sup>

Investimet e fundit infrastrukturore janë kryer para 3 vitesh. Përkundër faktit se investimet janë mjaft të vonshme, shumë obligime që dalin nga ligji që siguron qasje të barabartë për personat me aftësi të kufizuar nuk janë përfillur. Shkolla posedon një pjerrinë në katin e parë, por nuk ka ashensor për katin e dytë, nuk ka sinjalistikë apo akustikë adekuate për të shurdhër e të verbër dhe as edhe një tualet të akomoduar për këtë kategori. Krejt kjo duke i pasur 3 nxënës me nevoja të tilla që ndjekin mësimet aty. Shkolla e ka asistenten për persona që nuk kanë shikim të mirë, pra interpreten e gjuhës së shenjave. Kurse pjesa tjetër e mësimdhënësve nuk kanë ndjekur ndonjë program të aftësimi special profesional për personat me aftësi të kufizuar.<sup>163</sup>

Shkolla ka staf të trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut. Ata përmes doracakëve të ofruar nga disa OJQ janë të mirëinformuar për të drejtat e fëmijëve, përfshirë Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Por udhëheqësia nuk është kujdesur ta ndajë me stafin apo nxënësit Konventën e Stambollit apo Ligjin për Mbrojtje kundër Diskriminimit. Momentalisht rendi dhe të drejtat në shkollë përcaktohen me Kod të Mirësjelljes në shkollë.<sup>164</sup>

Asnjë procedurë standarde nuk e kërkon identifikimin e orientimit seksual të punonjësve apo nxënësve. E as për këtë temë apo ndonjë motiv tjetër që do të krijonte bazë për diskriminim shkolla nuk ka pranuar ndonjëherë raportim apo ankesë. Në kuadër të këtij institucioni arsimor vepron Këshilli i Nxënësve i cili organizon debate për vetëdijesimin e nxënësve ndaj bullizmit. E vetë institucioni e përkrah këshillin dhe u jep hapësirë organizimit të debateve dhe punëtorive për këto tema.<sup>165</sup>

<sup>162</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Gjimnazin “Zenel Hajdini”, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>163</sup>Intervista e Kallxo.com me Shkelqim Latifin - koordinatoriin e Gjimnazit “Zenel Hajdini”, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>164</sup>Intervista e Kallxo.com me Shkelqim Latifin - koordinatoriin e Gjimnazit “Zenel Hajdini”, 3 Maj 2023, Gjilan

<sup>165</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Gjimnazin “Zenel Hajdini”, 3 Maj 2023, Gjilan



## Sfidat e Komunës së Vitisë

|  |            |   |                 |
|--|------------|---|-----------------|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | <b>Po</b>  | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                      | Nuk ka të dhëna |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | <b>Jo</b>  | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                    | <b>Po</b>       |
| Punësimi i komuniteteve                              | <b>Po</b>  | Staf i trajnuar mbi rregullat ligjore për të drejtat e njeriut  | Pjesërisht      |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Pjesërisht | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare         | Pjesërisht      |
| Tualetet e qasshme për persona me aftësi të kufizuar | <b>Po</b>  | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+ | <b>Jo</b>       |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | <b>Po</b>  | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                      | <b>Jo</b>       |

Komuna e Vitisë ka gjithsej 1,160 të punësuar prej tyre 524 apo 45.17% janë gra, ndërsa 636 apo 54.82 për qind janë burra.<sup>166</sup> Kjo situatë paraqet përfaqësim jo të barabartë gjinor bazuar në kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore, i cili kërkon që çdo institucion publik të ketë përfaqësim gjinor 50-50.<sup>167</sup>

Dallimet gjinore janë të hapura edhe në drejtoritë e komunës, ku nga 9 sosh, 6 drejtohen nga burrat dhe vetëm 3 nga gratë.<sup>168</sup> Obligimi për përfaqësim të barabartë gjinor është i obligueshëm ligjor edhe për nivelet vendimmarrëse. Grua në këtë qytet është edhe drejtuesja e QKMF-së si dhe 4 nga gjithsej 17 shkolla drejtohen prej grave.<sup>169</sup>

Është një praktikë e cila megjithatë mund të merret si masë afirmative nga vajzat/gratë, në rregulloren për ndarjen e bursave për studentë, është përcaktuar që në kushte të barabarta u jepet përparësi vajzave në përfitim të bursës.<sup>170</sup>

Në Komunën e Vitisë momentalisht nuk ka as sinjalistikë e as akustikë për persona të verbër dhe të shurdhër e as ashensorë apo tualetet e përshtatura për nevojat e personave me aftësi të kufizuar. Megjithatë infrastruktura rrugore, si trotualet, objektet e administratës komunale janë të rregulluara me pjerrina dhe parkingjet janë të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar. Por në planifikimin komunal janë rregullimi i një pikatoreje për persona të verbër, e cila do të rregullohet në sheshin e qytetit (në bashkëfinancim me Qendrën Kosovare për Siguri Publike), si dhe dy projekte në infrastrukturën rrugore, ndërtimi i dy trotuareve në dy rrugë lokale (me pjerrina për PAK-të) dhe dy shetitore. Momentalisht në proces është vendosja e ashensorit në QKMF-në e qytetit. Gjithë këto mangësi ekzistojnë anipse në krejt komunën ndjekin mësimet 40 nxënës me nevoja esenciale për to, e në vetë institucionet komunale e punësuar nga kjo kategori është vetëm një grua në pozitën e recepionistes në QKMF.<sup>172</sup> Një numër i tillë i të punësuarve në institucione publike nuk është i mjaftueshëm përkitazi me masat obligative të përcaktuara me ligj që për çdo pesëdhjetë të punësuar të ketë një të punësuar me aftësi të kufizuar.<sup>173</sup>

<sup>166</sup>Korrespondenca elektronike e Kallxo.com me Sokol Haliti - kryetar në Komunën e Vitisë, 11 Tetor 2023

<sup>167</sup>Ligji për Barazi Gjinore, neni 3 para. 1.15, neni 6, para. 8

<sup>168</sup><https://kk.rks-gov.net/viti/drejtoreve/>, 27 Tetor 2023

<sup>169</sup>Ligji për Barazi Gjinore, neni 3 para. 1.15

<sup>170</sup>Korrespondenca elektronike e Kallxo.com me Sokol Haliti - kryetar në Komunën e Vitisë, 11 Tetor 2023

<sup>171</sup>Korrespondenca elektronike e Kallxo.com me Sokol Haliti - kryetar në Komunën e Vitisë, 11 Tetor 2023

<sup>172</sup>Korrespondenca elektronike e Kallxo.com me Sokol Haliti - kryetar në Komunën e Vitisë, 11 Tetor 2023

<sup>173</sup>Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 12, para. 2

Komuna e Vitisë nuk ka asnjë procedurë standarde e cila kërkon identifikimin e orientimit seksual të punonjësve të saj, marrësve të shërbimeve apo nxënësve. Aty po ashtu nuk organizohet ndonjë aktivitet, ditë simbolike apo diçka tjetër përmes së cilës e shënojnë diversitetin seksual në qytet.<sup>174</sup>

Vitia nuk ka qenë në gjendje të ofrojë të dhëna empirike rreth numrit të nxënësve nga komunitetet pakicë që ndjekin mësimet aty, dhe as sa nxënës jo-shqiptar mësojnë në shkollat shqipe.<sup>175</sup>

Duke u përpjekur që raporti të hedhë dritë mbi punësimin e komuniteteve pakicë në institucionet publike, jemi interesuar të dimë sa të tillë janë të punësuar në institucionet publike në nivel komunal. Përveç shqiptarëve në institucionet lokale të këtij qyteti punojnë edhe 3 serbë. Asnjëri prej tyre nuk është në pozitë udhëheqëse.

Kur vjen puna te diskriminimi, lloji më i shpeshtë i diskriminimit i ndeshur në Viti është pikërisht punësimi i personave me aftësi të kufizuar.<sup>176</sup>

Për Konventën e Stambollit janë organizuar trajnime me një pjesë të punonjësve nga të gjitha institucionet, kurse Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve nuk e kanë shpërndarë me të punësuarit apo nxënësit.<sup>177</sup>

Në komunën e Vitisë janë të punësuar 168 persona, prej të cilëve 100 apo 59.52 për qind janë burra kurse 68 apo 40.47 për qind janë gra.<sup>178</sup> Kjo situatë paraqet përfaqësim jo të barabartë gjinor bazuar në kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore, i cili kërkon që çdo institucion publik të ketë përfaqësim gjinor 50-50.<sup>179</sup>

Objekti i Komunës ka parking të shënjestuar, pjerrinë për qasje, ashensor, sinjalistikë dhe tualet të përshtatur. Megjithatë mungon akustika për njerëz të verbër,<sup>180</sup> e kjo gjë bie ndesh me kërkesat ligjore për krijimin e qasjes së barabartë për këta persona.

---

<sup>174</sup>Korrespondenca elektronike e Kallxo.com me Sokol Haliti - kryetar në Komunën e Vitisë, 11 Tetor 2023

<sup>175</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Komunën e Vitisë, 15 Qershor 2023, Viti

<sup>176</sup>Korrespondenca elektronike e Kallxo.com me Sokol Haliti - kryetar në Komunën e Vitisë, 11 Tetor 2023

<sup>177</sup>Korrespondenca elektronike e Kallxo.com me Sokol Haliti - kryetar në Komunën e Vitisë, 11 Tetor 2023

<sup>178</sup>Pyetësori i Kallxo.com me Komunën e Vitisë, 15 Qershor 2023, Viti

<sup>179</sup>Ligji për Barazi Gjinore, neni 3 para. 1.15, neni 6, para. 8

<sup>180</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në Objektivin e Komunës së Vitisë, 15 Qershor 2023, Viti

## Kapacitetet në Qendrën Kryesore e Mjekësisë Familjare - Viti

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti ka 142 të punësuar prej të cilëve 88 apo 61.47 për qind janë gra dhe 54 apo 38 për qind janë burra.<sup>181</sup> Kjo situatë paraqet përfaqësim jo të barabartë gjinor përkitazi me kërkesat ligjore, dhe atë në dëm të burrave. Gratë po ashtu drejtojnë institucionin përmes udhëheqjes së disa prej pozicioneve kryesore në këtë institucion shëndetësor, përfshirë drejtoreshën e tij, kryeshafen e mjekësisë familjare, koordinatoren për zhvillim të vazhdueshëm profesional, shafen e QMF-së më të madhe dhe shafen e pediatriës.<sup>182</sup>

Në institucionin kryesor të shëndetit në Viti nuk ka asnjë të punësuar nga komunitetet pakicë.<sup>183</sup>

Në Qendër nuk ka të punësuar as nga radhët e personave me aftësi të kufizuar, dhe kjo është në kundërshtim me kërkesat ligjore për punësimin e kësaj kategorie.<sup>184</sup>

Investimet e kryera në vitin 2022, 2023 dhe të cilat po vazhdojnë akoma i kanë adresuar një pjesë të kërkesave ligjore për akomodimin e personave me aftësi të kufizuar, siç janë pjerrinat dhe ashensori, i cili është në rregullim e sipër. Por vazhdon të mungojë akustika për të verbër dhe tualetet për personat me aftësi të kufizuar. Në institucion nuk ka një asistent që do t'i shërbente personave me aftësi të kufizuar. Stafi ka ndjekur programe të aftësimin special profesional për personat me aftësi të kufizuar.<sup>185</sup>

Stafi i qendrës nuk është i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut dhe e njëjta nuk ka pranuar asnjëherë ndonjë raportim apo ankesë me bazë diskriminimi.<sup>186</sup>

---

<sup>181</sup>Pyetësi i Kallxo.com me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti, 15 Qershor 2023, Viti

<sup>182</sup>Pyetësi i Kallxo.com me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti, 15 Qershor 2023, Viti

<sup>183</sup>Pyetësi i Kallxo.com me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti, 15 Qershor 2023, Viti

<sup>184</sup>Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, neni 12, para. 1

<sup>185</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në QKMF-në e Vitisë, 15 Qershor 2023, Viti

<sup>186</sup>Pyetësi i Kallxo.com me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti, 15 Qershor 2023, Viti

## Kapacitetet e limituara në Shkollën e Mesme - Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës” - Viti

|  |            |  |                 |
|--|------------|--|-----------------|
| Grua/Gra në pozita udhëheqëse                        | Jo         | Asistent për persona me aftësi të kufizuar                         | Jo              |
| Përfaqësimi gjinor i barabartë                       | Jo         | Ankesa për diskriminim në institucionin tuaj                       | Jo              |
| Punësimi i komuniteteve                              | Jo         | Staf i trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut | Jo              |
| Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuar     | Pjesërisht | Edukimi i stafit/studentëve për konventat ndërkombëtare            | Nuk ka të dhëna |
| Tualete të qasshme për persona me aftësi të kufizuar | Jo         | Imponomi i deklarimit të orientimit seksual për personat LGBTI+    | Nuk ka të dhëna |
| Vizioni për përshtatjen e hapësirave                 | Po         | Punësimi i personave me aftësi të kufizuar                         | Jo              |

Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës” është vend pune për 66 persona, prej të cilëve 26 apo 39.39 për qind janë gra dhe 40 apo 60.60 për qind janë burra. Asnjë grua nuk është në pozicione menaxheriale.<sup>187</sup> Në shkollë ndjekin mësimet 800 nxënës, prej të cilëve 472 apo 59 për qind janë vajza dhe 328 apo 41 për qind janë djem. Të gjithë këta nxënës janë shqiptarë.<sup>188</sup>

Në qasjen e personave me aftësi të kufizuar gjimnazi ka dy pjerrina, por i mungojnë akustika për të verbër, ashensori, parkingjet e shenjzuara, tualetet e akomoduar. Lajmi i mirë është që shkolla do të përfitojë 600,000 Euro renovime nga fondet e IPA 3 këtë vit. Shkolla arsyetohet se mungojnë tualetet e akomoduar sepse objekti është i vjetër. Për më tepër në këtë institucion arsimor nuk ka asistent për persona që i përkasin kësaj kategorie.<sup>189</sup>

Gjimnazi ka staf të trajnuar mbi rregullativën ligjore për të drejtat e njeriut, por nuk ka pranuar asnjëherë ndonjë ankesë me bazë diskriminimi. Por kur ka ndonjë rast që nxënësit bëhen viktimat të dhunës, diskriminimit, ngacmimeve, atëherë me këto çështje merret psikologu i shkollës. Stafi tjetër nuk ka ndjekur ndonjë program të aftësimi special profesional për këta persona por psikologu ka kryer nivelin e pestë të programit për fëmijët me aftësi të kufizuar të organizuar nga MASHTI.<sup>190</sup>

<sup>187</sup>Pyetësi i Kallxo.com me Gjimnazin “Kuvendi i Lezhës”, 15 Qershor 2023, Viti

<sup>188</sup>Pyetësi i Kallxo.com me Gjimnazin “Kuvendi i Lezhës”, 15 Qershor 2023, Viti

<sup>189</sup>Vizita e ekipit të Kallxo.com në Gjimnazin “Kuvendi i Lezhës”, 15 Qershor 2023, Viti

<sup>190</sup>Pyetësi i Kallxo.com me Gjimnazin “Kuvendi i Lezhës”, 15 Qershor 2023, Viti





## Rekomandimet

- Institucionet publike rekomandohen të zhvillojnë politika të punësimit të cilat inkurajojnë përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë;
- Komunitetet jo-shumicë rekomandohet të përfshihen në pozicione udhëheqëse sidomos në ato arsimore;
- Institucionet publike rekomandohen të nisin implementimin e obligimeve ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuar;
- Hapësirat e punës në insitucionet publike të adoptohen për të garantuar mundësi për punë për personat me aftësi të kufizuar;
- Qeveria e Kosovës rekomandohet të nisë një proces të identifikimit të institucioneve që nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuar sipas kuotës së përcaktuar me ligj;
- Universitetit i Prishtinës rekomandohet të përfshijë në stafin e tij pjestarë nga komunitetet jo-shumicë.
- Hapësirat publike përreth ndërtesave rekomandohen të adaptohen për qasje për personat me aftësi të kufizuar.
- Ministria e Arsimit dhe komunat rekomandohen të kryejnë investime në përshtatjen e hapësirave të shkollave për qasje për personat me aftësi të kufizuar.
- Qendrat për punë sociale rekomandohen të zbatojnë standardet e qasjes dhe barazinë gjinore në punësim;
- Komunat e Kosovës rekomandohet të nisin të promovojnë politika që mundësojnë përfshirjen më të madhe të grave në pozita udhëheqëse;
- Qeveria e Kosovës rekomandohet që të përcaktojë standarde të ndërtimit të cilat do zbatohen në të gjitha institucionet publike ku përcaktohen rregullat dhe standardet e qasjes për personat me aftësi të kufizuar;
- Institucionet publike rekomandohen të edukojnë stafin për rregullativën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
- Institucionet publike duhet të krijojnë procedura standarde që obligojnë për zyrtarët njohjen të marrin njohuri adekuate për Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, Konventën e Stambollit dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve;
- Institucionet e vendit të nisin fushatë edukuese të cilat fuqizojnë raportimin e diskriminimit dhe ngritjen e çështjeve të diskriminimit;
- Institucionet publike të ndërmarrin aktivitete të cilat promovojnë barazinë dhe tolerancën veçanërisht ndaj grupeve të marginalizuara dhe komunitetit LGBTI+.

## Udhëzues shpjegues për rregullat ligjore

Republika e Kosovës ka krijuar obligime ligjore për institucionet në raport me luftimin e diskriminimit dhe përkrahjen e grupeve të marginalizuara.

Kushtetuta e përcakton vendin si shoqëri shumëetnike.<sup>191</sup> Ajo përcakton se askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

Për më tepër, vetë akti më i lartë i vendit e afirmon konceptin e njohur si “diskriminim pozitiv” duke pranuar vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë, përkohësisht, përkundër parimeve të mbrojtjes së barabartë ligjore.<sup>192</sup>

Në kuptim të dispozitave kushtetuese, Kosova ka një qasje të promovuese jo vetëm në raport me integrimin e plotë të komuniteteve etnike në vend por edhe ruajtjen dhe të zhvillimin e identitetit të tyre. Kushtetuta vendos themelet për arsim në gjuhën amtare, media në gjuhën amtare e madje edhe kontakt të papenguar me cilindo shtet dhe veçanërisht shtetin me të cilin kanë karakter të përbashkët.<sup>193</sup>

E drejtë e garantuar është edhe punësimi i komuniteteve në organet dhe ndërmarrjet publike. E aty ku komunitetet përbëjnë së paku 10 për qind të popullatës, pa e përbërë shumicën, do të gëzojnë postin e zëvendëskryetarit të komuniteteve të kuvendit të komunës.<sup>195</sup>

Mbrojtja në këtë segment më tutje konkretizohet me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Të gjitha institucionet shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat duhet të veprojnë në pajtim me parimet e tij.<sup>196</sup> Ky ligj e konsideron diskriminim mosofrimin e një infrastrukture të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat e tyre, përveçse kur është një barrë e paarsyeshme për personin që është i detyruar ta ofrojë dhe kjo nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.<sup>197</sup>

Të gjitha ministritë dhe komunitat janë të obliguara të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. Qeveria, sipas propozimit të Zyrës për Qeverisje të Mirë, përmes aktit nënligjor përcakton mënyrën e koordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit me Zyrën për Qeverisje të Mirë, të mekanizmave institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi.<sup>198</sup>

Sanksionet për shkeljet e dispozitave të këtij Ligji janë të karakterit penal në rastet kur ka vepër penale<sup>199</sup> ndërsa në rastet kur diskriminimi është kundërvajtje, sipas këtij ligji, është i dënueshëm me gjobë. Mbrojtja ligjore garantohet edhe me paditë civile të cilat mund të dërgohen në gjykatë.<sup>200</sup>

<sup>191</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3, para. 1

<sup>192</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24, para. 2 dhe 3

<sup>193</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 59

<sup>194</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 61

<sup>195</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 62, para. 1

<sup>196</sup>Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 2, para. 1

<sup>197</sup>Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 4, para. 1.8.

<sup>198</sup>Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 11

<sup>199</sup>Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 17

<sup>200</sup>Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 13

Baza tjetër ligjore e cila e lufton diskriminimin është Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Ky ligj përcakton se personi me aftësi të kufizuar ka të drejtë në aftësim, riaftësim profesional. Aty thuhet se në rastet e caktuara, kur është e nevojshme aftësimi, riaftësimi mund të bëhet në shkollat e veçanta dhe institucione tjera sipas plan-programeve për aftësimin, riaftësimin profesional.<sup>201</sup> Sipas këtij ligji çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuar në çdo pesëdhjetë punëtorë. E organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës, t`i punësojnë personat me aftësi të kufizuar. Përkitazi me këto dispozita, punëdhënësi dhe personi përgjegjës i tij dënohet me gjobë në të holla prej 500 deri 2000 euro nëse bëjnë diskriminim në punësim apo nëse nuk paguajnë kontributin e posaçëm për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuar.<sup>202</sup> Sipas obligimit ligjor, punëdhënësi paguan në buxhetin e Kosovës kontribute mujore në lartësi prej 1 për qind të shumës së pagës minimale, nëse nuk i evidentojnë të punësuarit e tyre me aftësi të kufizuar te zyrat e punësimit, si dhe në rast se Qendrat për aftësim donacionet i shfrytëzojnë për qëllime tjera.<sup>203</sup> Sipas ligjit, financimi për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar bëhet nga buxheti i Kosovës.<sup>204</sup> Për këtë kategori janë të dedikuara edhe dy udhëzime administrative: Udhëzimi Administrativ për Vlerësimin e Aftësisë së Mbetur për Punë - për të cilin organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuar shprehen se nuk aplikohet fare,<sup>205</sup> si dhe Udhëzimi Administrativ për mënyrën, procedurat dhe afatet e pagesës mujore për punëdhënësit të cilët nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuar.

Në frymën e luftimit të diskriminimit dhe ofrimin e një qasje gjithëpërfshirëse është edhe Ligji për arsimin parauniversitar.

Konform dispozitave të tij, qasja dhe zhvillimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin parauniversitar do të mundësohet pa diskriminim në baza ekzistuese ose të supozuara, siç është ai: gjinor, racor, i orientimit seksual, i paaftësitë fizike, intelektuale ose i çfarëdo paaftësie tjetër, i gjendjes martesore, i ngjyrës, i fesë, i opinioneve politike apo të tjera, i përkatësisë kombëtare, etnike ose shoqërore, i shoqërimit me ndonjë komunitet, i pronës, i lindjes ose i ndonjë gjendje tjetër të nxënësit apo familjes së tij.<sup>206</sup>

Librat në gjuhët e komuniteteve duhet të jepen falas.<sup>207</sup>

Institucionet arsimore dhe aftësuese në vendin tonë duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera.<sup>208</sup> Për më tepër, fëmija nuk duhet të konsiderohet se ka vështirësi në mësim vetëm për shkak se gjuha, ose forma e gjuhës, në të cilën zhvillohet mësimi nuk është e njëjtë me gjuhën, ose me formën e gjuhës, të cilën e përdor në shtëpi të tij ose sepse i takon një komuniteti të caktuar dhe në rastet e tilla komuna duhet të sigurojë që fëmijës t`i ofrohet mbështetje e efikase në gjuhën e mësimdhënies.<sup>209</sup>

I mbetet vlerësimin individual të komunave sigurimi i transportit falas, të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuar apo me vështirësi në mësim që ndjekin mësimet në shkollë komunale.<sup>210</sup> Nxënësve dhe fëmijëve të cilët përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë të tyre të parë, duhet t`u ofrohet mësimdhënie për përdorimin e gjuhës së shenjave dhe përmes mënyrës së gjuhës së shenjave.<sup>211</sup> Ata që kanë të parë të pjesshëm dhe ata që janë të verbër kanë të drejtën që të mësohen për përdorimin e alfabetit Brail, si dhe për ndihmat teknike të nevojshme. Nxënësit e këtyre kategorive kanë gjithashtu edhe të drejtën për orientimin e nevojshëm dhe për udhëzime gjatë lëvizjes në shkollë, vajtjen dhe kthimin nga shkolla dhe në shtëpi.<sup>212</sup>

Edhe Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë përçon të njëjtën frymë gjithëpërfshirëse. Një prej parimeve themelore të tij është dhënia e mundësive të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim.<sup>213</sup>

<sup>201</sup>Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 8

<sup>202</sup>Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 25

<sup>203</sup>Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 12

<sup>204</sup>Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 24

<sup>205</sup>Korrospodenca elektronike e Kallxo.com me HANDIKOS, 30 Tetor 2023

<sup>206</sup>Ligji për Arsimin Parauniversitar, Neni 6

<sup>207</sup>Ligji për Arsimin Parauniversitar, neni 27

<sup>208</sup>Ligji për Arsimin Parauniversitar, neni 40, para. 2.1.

<sup>209</sup>Ligji për Arsimin Parauniversitar, neni 39, para. 2

<sup>210</sup>Ligji për Arsimin Parauniversitar, neni 40, para 1.3

<sup>211</sup>Ibid, neni 43, para. 1

<sup>212</sup>Ligji për Arsimin Parauniversitar, neni 43, para. 3

<sup>213</sup>Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, neni 2, para. 1.3

Ligji për Arsimin në Komunitet e Kosovës obligon komunitet që të krijojnë kushtet për ofrimin e shërbimeve edukativo-arsimore në gjuhën serbe.<sup>214</sup>

Në shtator të vitit 2016 Qeveria e Kosovës kishte nxjerrë udhëzim administrativ me qëllim të përcaktimit të masave afirmative për regjistrimin e kandidatëve nga komunitetet jo-shumicë në institucionet publike të arsimit të lartë me lehtësira. Përmes tij, qeveria kishte përcaktuar kuota për vende të rezervuara për të gjitha komunitetet jo-shumicë, për nivelet bachelor, master dhe doktoratë.<sup>215</sup> Më tutje ishte përcaktuar obligimi që Universitetet t'i mbajnë provimet përveç shqipes edhe në: gjuhën turke, boshnjake dhe serbe.<sup>216</sup> Kuotat për regjistrimin e studentëve nga komunitetet jo-shumicë në institucionet publike të arsimit të lartë përfshijnë 12 për qind të numrit të përgjithshëm të studentëve për praninë, sipas konkursit, në çdo njësi akademike të tyre.<sup>217</sup> Për më tepër, MASHTI dhe institucionet publike të arsimit të lartë të cilat kanë kapacitete për konvikte dhe mensa ushqimi për studentë, duhet të rezervojnë 12 për qind nga numri i përgjithshëm, për studentët e komuniteteve jo-shumicë.<sup>218</sup>

Komuna e Mitrovicës së Veriut është e vetmja komunë me kompetenca për shkollim të lartë, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve shkollore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve arsimorë.<sup>219</sup> Kjo është një kompetencë e zgjeruar e kësaj komune dhe e cila kontribuon më tutje në kultivimin e të drejtave minoritare të komunitetit serb dhe u mundëson atyre që në mënyrë të pavarur të drejtojnë jetën dhe politika universitare të institucioneve të arsimit të lartë aty. Për më tepër, të gjitha komunitet në të cilat komuniteti serb është shumicë, kanë kompetenca për të ushtruar përgjegjësitë për çështjet kulturore, duke përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe religjioze serbe dhe të tjerëve.<sup>220</sup>

Obligime të tjera dalin nga Ligji për Barazi Gjinore. Ky ligj vlen për burrat, gratë dhe personat që kanë një karakteristikë të mbrojtur të identitetit gjinor apo të seksit, si dhe garanton mundësi dhe trajtim të barabartë, në sferën publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet shoqërore, sportin, kulturën dhe sferat tjera të përcaktuara me ligj.<sup>221</sup> Se a janë gra apo burra do të mbetet në atë se si çdo person e konsideron veten.<sup>222</sup> Kurse identiteti gjinor, përkitazi me këtë akt, nuk është domosdo i lidhur me seksin që personi e ka pasur në lindje.<sup>223</sup> Ligji ka paraparë dy situata të diskriminimit, atë që kryhet drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të tërthortë. I pari paraqitet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohej një person i gjinisë tjetër në një situatë të krahasueshme, kurse i dyti konsiderohet se ndodh kur, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin e gjinisë tjetër në pozitë të pabarabartë, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme.<sup>224</sup>

<sup>214</sup>Ligji për Arsimin në Komunitet e Kosovës neni 12,

<sup>215</sup>Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.: 09/2016 Aplikimi i Masave Afirmative dhe Vendeve të Rezervuara për Regjistrim të Kandidatëve nga Komunitetet joshumicë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, neni 1 dhe neni 2, para. 2

<sup>216</sup>Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.: 09/2016 Aplikimi i Masave Afirmative dhe Vendeve të Rezervuara për Regjistrim të Kandidatëve nga Komunitetet joshumicë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, neni 3, para. 3

<sup>217</sup>Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.: 09/2016 Aplikimi i Masave Afirmative dhe Vendeve të Rezervuara për Regjistrim të Kandidatëve nga Komunitetet joshumicë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, neni 4, para. 1

<sup>218</sup>Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.: 09/2016 Aplikimi i Masave Afirmative dhe Vendeve të Rezervuara për Regjistrim të Kandidatëve nga Komunitetet joshumicë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, neni 7, para. 1

<sup>219</sup>Ligji për Vetëqeverisje Lokale, neni 21

<sup>220</sup>Ligji për Vetëqeverisje Lokale, neni 22, para. 22.1

<sup>221</sup>Ligji për Barazi Gjinore, Neni 2

<sup>222</sup>Ligji për Barazi Gjinore, Neni 3, para. 1.2 dhe 1.3

<sup>223</sup>Ligji për Barazi Gjinore, Neni 3, para. 1.9

<sup>224</sup>Ligji për Barazi Gjinore, neni 3, para. 1.5 dhe 1.6

Me qëllim të afirmimit të barazisë gjinore, Kosova i ka vënë obligim vetes punësim numerikisht të barabartë të punësit në institucionet publike, me ç'rast decidivisht ka përcaktuar se përfaqësimi i pabarabartë është vetëm atëherë kur pjesëmarrja apo përfaqësimi i njëres gjini është më i ulët se 50 për qind në çdo organ dhe nivel vendimmarrës në jetën politike dhe publike.<sup>225</sup> E përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej 50 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.<sup>226</sup> Këto mënyra të shprehjes së diskriminimit janë të ndaluara në Kosovë e për më tepër diskriminim konsiderohet edhe dhuna e ushtruar me motiv gjinor.<sup>227</sup>

Në institucionet publike qendrore, minimum 10 për qind e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, ndërsa në nivelin komunal, plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë.<sup>228</sup> Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim.<sup>229</sup> Pjesëmarrja në qeverisjen lokale për pakicat garantohet përveç tjerash përmes themelimit të zyrës së Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete dhe nënkryetarit të Komunës për Komunitete.

Kur vjen puna tek imponimi i identifikimit të orientimit seksual nga institucionet publike e cila ndonëse është një praktikë e rrallë nuk është inekzistente, nuk ka një ndalim shprehimor për këtë çështje. Por marrë parasysh se shumë aktivistë dhe organizata që përfaqësojnë këto komunitete një identifikim të tillë e shohin si akt diskriminues, shumë dispozita lehtas interpretojnë këtë praktikë si akt diskriminimi. Këtu përfshihet Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi ku përcaktohet se qëllimi i ligjit është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në shumë kategori, duke përfshirë identitetin gjinor dhe orientimin seksual;<sup>230</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila përcakton të drejtën për respektin e jetës private<sup>231</sup> dhe familjare, si dhe ndalimin e diskriminimit në disa kriterë, përfshirë orientimin seksual;<sup>232</sup> Direktiva e Përgjithshme e BE-së për Barazi në Punë e cila po ashtu ndalon diskriminimin në disa fusha, përfshirë orientimin seksual, në punë dhe karrierë;<sup>233</sup> Rregullorja e Përgjithshme e BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave e njohur si GDPR e cila vendos rregulla mbi trajtimin e të dhënave personale ndonëse nuk adreson specifikisht pyetjen mbi orientimin seksual, ka dispozita mbi pajtimin, minimizimin e të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale, së fundmi Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr. 111 ndalon diskriminimin në punë dhe profesion, përfshirë diskriminimin në bazë të seksit apo gjinisë.<sup>234</sup>

<sup>225</sup>Ligji për Barazi Gjinore, neni 3, para. 1.15

<sup>226</sup>Ligji për Barazi Gjinore, neni 6, para. 8

<sup>227</sup>Ligji për Barazi Gjinore, neni 4, para. 1

<sup>228</sup>Ligji për Zyrtarët Publik, neni 10

<sup>229</sup>Ligji për Vetëqeverisje Lokale, neni 4, para. 4.2

<sup>230</sup>Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 1

<sup>231</sup>Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 8

<sup>232</sup>Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14

<sup>233</sup>Direktiva e Përgjithshme e BE-së për Barazi në Punë, neni 11 dhe 12

<sup>234</sup>Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, neni 1, para. 1



Funded by  
the European Union



Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj



INTERNEWS KOSOVA